



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister

Zyra Ligjore - Zakonodavna Kancelarija - Legal Office

**Raporti për Thjeshtësimin dhe Harmonizimin e Lejeve dhe Licencave në
Zyrën e Rregullatorit të Energjisë¹**

¹Kjo analizë juridike është miratuar në Mbledhjen e 254-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 04/254 të datës 26.03.2025.

ARBK-Agjencia e regjistrimit të bizneseve të Kosovës

GIZ - Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit

KGJK-Këshilli Gjyqësor i Kosovës

LPPA - Ligji Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative

LRE-Ligji Nr. 05/L-084 Për Rregullatorin e Energjisë

LSLL-Ligji Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave

LZRRE- Ligji për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë

MMPHI-Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

PVK – Pikat e Vetme të Kontaktit

RQLL-Regjistri Qendror i Lejeve dhe Licencave

ZKM - Zyra e Kryeministrit

ZL - Zyra Ligjore

ZRRE – Zyra e Rregullatorit të Energjisë

1.Hyrje

Ky raport i mbështetur nga GIZ ka për qëllim që të pasqyrojë të gjeturat dhe rekomandimet e përgjithshme dhe konkrete, për thjeshtimin e procedurave për aplikim, shqyrtim dhe pajisjen me leje dhe licenca në ZRRE si dhe të bëjë harmonizimin e lejeve dhe licencave të ZRRE me kërkesat dhe kriteret e LSSL. Thjeshtësimi i lejeve dhe licencave është vlerësuar në kuadër të disa parimeve dhe kërkesave të cilat përcaktohen në LSSL si dhe në LPPA, kurse harmonizimi është vlerësuar në kuadër të përshtatshmërisë së ligjeve të veçanta, veçanërisht LZRRE me LSSL.

Në kuadër të këtij raporti është ndjekur metodologji e atillë, ku janë nxjerrë: **1.Rekomandime të përgjithshme dhe 2.Rekomandime të veçanta**, për lejet dhe licencat të cilat i aplikon ZRRE. Rekomandimet e veçanta janë të vendosura në shtojcën e këtij raporti dhe janë të dhëna për secilën leje ose licencë, në mënyrë të veçantë, sipas të gjeturave.

Po ashtu, përveç rekomandimeve në raport janë përshkruar edhe të gjeturat kryesore si dhe të gjeturat e veçanta, të cilat ndjekin qëllimin e raportit, për thjeshtëzimin e lejeve dhe licencave si dhe harmonizimin e tyre me LSSL.

Thjeshtëzimi i lejeve dhe licencave dhe harmonizimi i tyre në ZRRE, sipas këtij raporti, merr parasysh veçanërisht:

1. Lehtësimi i procedurës së aplikimit për leje dhe licenca;
2. Lehtësimi i barrës administrative të palës me rastin e aplikimit;
3. Lehtësimi i procedurës së shqyrtimit të kërkesës dhe verifikimit të provave/dëshmime;
4. Çështjen e sigurisë së bartësit të licencës, në kuptim të zgjatjes së afatit, bazuar në kriteret e specifikave të licencave ose lejeve, varësisht nga niveli i rrezikshmërisë;
5. Çështja e ligjshmërisë së licencave, dhe bazës specifike ligjore, në kuptimin që të njëjtat të jenë të parapara me ligj, sipas emërimit nga ZRRE, bazuar në regjistrin qendror të lejeve dhe licencave;
6. Çështjen e harmonizimit dhe përshtatshmërisë së kërkesave të LSSL me rregullimet e përcaktuara në LZRRE dhe aktet nënligjore.

Për të hartuar këtë raport janë shqyrtuar disa burime dhe atë si në vijim: LSSL; LPPA; LZRRE; Ligjet e veçanta të aplikuara nga ZRRE; Aktet nënligjore të ZRRE që rregullojnë procedurën e pajisjes me leje dhe licenca që i lëshon ZRRE; RQLL. Po ashtu një rëndësi të veçantë e kanë pasur edhe takimet me institucionet relevante, në këtë rast ZRRE ka dhënë edhe komente në raport, të cilat kanë shërbyer për sqarime shtesë.

Për efekte të këtij raporti është përdorur terminologjia e emërimit “leje dhe licenca” sipas LSSL që përfshijnë edhe aplikimin e llojeve të tjera të lejimeve që lëshohen nga ZRRE dhe nuk emërtohen si leje dhe licenca. Në kuadër të këtij raporti, ZRRE ka dhënë komente dhe të cilat janë konsideruar dhe janë marrë parasysh përgjatë finalizimit.

2.Analiza ligjore përkitazi me thjeshtëzimin e lejeve dhe licencave

Në këtë pjesë prezantohet analiza e legjislacionit kryesor që rregullon lejitimet (lejet dhe licencat) në ZRRE. Ligji për sistemin e lejeve dhe licencave (LSSL) është ligji horizontal që në nenin 1 rregullon parimet dhe rregullat për përmirësimin e mjedisit për të bërë biznes, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative, në kryerjen e veprimtarive ekonomike, tregtare apo profesionale, që është e domosdoshme për të mbrojtur shëndetin publik, sigurinë publike, mjedisin dhe përdorimin e resurseve natyrore në Republikën e Kosovës. Ligj tjetër horizontal që rregullon në përgjithësi ushtrimin e autoritetit publik ku më së shpeshti vie në

shprehje tek lejimet është Ligji për procedurën e përgjithshme administrative (LPPA), qëllimi i të cilit është të sigurojë realizimin efektiv të autoritetit publik në shërbim të interesit publik, duke garantuar në të njëjtën kohë në nenin 1 edhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave juridike të personave.

Në vijim do të analizojmë disa nga parimet dhe rregullat kryesore të parashikuara në këto ligje dhe rregullat si dhe kriteret e veçanta që përcaktohen me Ligjin për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë Nr. 05/L-084 (LZRRE) si dhe ligjet tjera, për lejet dhe licencat në ZRRE.

Sa më sipër, realizimi i qëllimit të raportit për lehtësimin e lejeve dhe licencave të cilat lëshohen nga ZRRE, kërkon një analizë të ligjeve të veçanta, siç është veçanërisht ligji për ZRRE dhe aktet nënligjore që i nxjerr ZRRE, në kuptim të lejeve dhe licencave të cilat i lejon, në veprimtaritë e caktuara. Përveç ligjit për ZRRE, sistemi i lejeve dhe licencave në ZRRE rregullohet, për aq sa është e nevojshme edhe me ligjet si: **Ligjin Nr. 05/L – 085 për Energjinë; Ligji Nr. 05/L – 085 për Energjinë Elektrike; Ligji Nr. 05/L-082 për Gazin Natyror; Ligjit Nr. 05/L -052 për Energjinë Termike.** Megjithatë këto ligje i referohen licencave dhe lejeve tjera që i lëshon ZRRE, vetëm në kuptimin e sqarimit të një personi juridik ose fizik të licencuar, pasi që sistemi i lejeve dhe licencave, procedura, mënyra e dhënies së tyre, kriteret etj, rregullohen me ligjin për ZRRE dhe aktet nënligjore (rregulloret) e nxjerra nga ZRRE, siç janë: **Rregullorja për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë ZRRE/Nr. 07/2017; rregulla për taksat Nr.01/2020; Rregulla - ZRRE/Nr. 03/2022 për procedurën e autorizimit për ndërtimin e projekteve të energjisë etj.**

Në kuptim të emërimit, LSSL në nenin 1 (1.3) përdor termin **“I licencuari – personi fizik të cilit i është lëshuar një licencë profesionale”**, në anën tjetër **Ligji Nr. 05/L – 085 për Energjinë Elektrike**, i referohet në nenin 1 (1.21) përcakton “I licencuar - është një person i pajisur me licencë për aktivitete të energjisë elektrike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, kurse në nenin 1 (1.46), përcakton se: **“Ndërmarrje e energjisë elektrike - personi fizik apo juridik që kryen një apo më shumë veprimtari të licencuara të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, furnizimit, tregtimit, tregut të organizuar të energjisë elektrike”**. Për dallim nga LSSL, siç mund të shihet Ligji i veçantë **Nr. 05/L – 085 për Energjinë Elektrike** “të licencuarit” i referohet personit fizik ose ndërmarrjes. Në anën tjetër Ligji për ZRRE në nenin 28.1. përcakton: **“Aktivitetet e energjisë, kryhen nga ndërmarrjet për energji në bazë të licencave të lëshuara nga Rregullatori”**, megjithëse në këtë rast i referohet vetëm ndërmarrjeve (personave juridik), si të licencuar të mundshëm. Në anën tjetër, në paragrafin 2 të nenit 28 nënkuptohet që ky nen i LZRRE aplikohet në përputhje edhe me ligjet e tjera varësisht prej kërkesave të Ligjit për Energjinë Elektrike, Ligjit për Gazin Natyror dhe Ligjin për Energjinë Termike etj. Megjithatë, kriteret për leje dhe licenca në këtë institucion përqendrohen dhe bazohen kryesisht në Ligjin për ZRRE. Sipas praktikës në ZRRE, autorizimet si lloje të lejeve dhe licencave mund të lëshohen edhe për persona fizik edhe për persona juridik. Kjo duhet të theksohet saktësisht me rregullore, në kuptimin që të saktësohet se kur aplikojnë personat fizik dhe kur personat juridik, gjithnjë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Përderisa LSSL në nenin 5 ka përcaktuar llojet e lejimeve, siç janë: *njoftimi, regjistrimi, leja dhe licenca profesionale*, në anën tjetër ZRRE njih dhe aplikon tri lloje të lejeve dhe licencave që emërtohen: *licencë, autorizim dhe licencim i aktivitetit*. Në anën tjetër ZRRE, sipas LZRRE njih edhe lejime ose aktivitete për të cilat nuk kërkohet licencë. Këtu aktivitete janë për: prodhimin e energjisë elektrike në lokacion energjetik me kapacitet total që nuk tejkalon pesë (5) MW; prodhimin e energjisë termike të prodhuar nga ngrohtoret për konsum vetanak apo me kapacitet që nuk tejkalon një 1 MW; prodhimin e energjisë elektrike për konsum vetanak, ku stabilimenti i prodhimit apo konsumatorët e energjisë elektrike nuk lidhen në sistemin e transmetimit apo sistemin e shpërndarjes, që si të tilla kanë të bëjnë me prodhimin e energjisë. Kjo përcaktohet me nenin 29 të Ligjit për ZRRE dhe të njëjtat trajtohen si kërkesa ose lejime të caktuara, përmes të cilave, ZRRE miraton kërkesat respektive të personave fizik ose juridik. Duhet theksuar se sistemi i licencave në ZRRE, nuk e njih termin “leje”, sikurse LSSL.

Në kuadër të sistemit të lejeve dhe licencave të cilat lëshohen nga ZRRE, bazuar në ligjin e ZRRE dhe ligjet e tjera të aplikueshme, të përmendura më sipër, çështja e lehtësimit të lejeve dhe licencave në këtë sektor siç u tha do të shikohet bazuar në disa parime, të cilat njihen nga LSSL dhe LPPA. Këto parime kanë për

qëllim të arrijnë në rekomandime konkrete, për të bërë lehtësimin e lejeve dhe licencave të ZRRE si dhe harmonizimin e tyre me kërkesat dhe kriteret e LSSL.

Zgjatja e afatit të licencës. Neni 32 i Ligjit për ZRRE ka përcaktuar kohëzgjatjen e licencave në kuadër të ZRRE, bazuar në një kategorizim, që varet nga lloji i lejimit. Sipas ligjit për ZRRE, një afat i licencës mund të zgjasë maksimalisht 40 vite varësisht nga kategorizimi. Kështu, 1. *Për shpërndarjen e energjisë elektrike, energjisë termike apo gazit natyror, apo deponimit të gazit natyror nuk mund të tejkalojë periudhën dyzet (40) vjeçare;* 2. *Për aktivitetet e furnizimit të energjisë elektrike, energjisë termike apo gazit natyror, apo operatorit të tregut të organizuar kohëzgjatje maksimale prej njëzet e pesë (25) vjetësh;* 3. *Për aktivitetet e Operatorit të Sistemit të Transmetimit apo Shpërndarjes me kohëzgjatje maksimale prej tridhjetë (30) vjetësh;* 4. *Për aktivitetet e furnizimit të garantuar të energjisë elektrike me kohëzgjatje maksimale prej tre (3) vitesh dhe* 5. *Për aktivitetet e furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike apo gazit natyror jo më shumë se pesë (5) vite dhe jo për më pak se një (1) vit.* Megjithatë vlerësimi për zgjatjen e afatit të licencës nga ZRRE është diskrecionar dhe ZRRE, në rastin e vendosjes për afatin e licencave sipas kategorive merr parasysh: 1. *Jetëgjatësinë e asetëve relevante të përdorura për kryerjen e veprimtarisë;* 2. *Gjendjen financiare të aplikuesit;* 3. *Rrethanat financiare të parashtruesit të kërkesës.*

Mos diskriminimi. Ky parim përcaktohet në nenin 6 të LPPA dhe si i tillë duhet të aplikohet edhe nga ZRRE, në raport me vendosjen për licencat dhe lejimet e tjera që i bën. Veçanërisht ky parim duhet të përcaktohet në mënyrë strikte kur bëhet fjale tek kohëzgjatja e licencës, të cilën ZRRE e vlerëson dhe e vendos, sipas diskreditonit duke u bazuar në kriteret e kohëzgjatjes minimale dhe maksimale të afatit të kohëzgjatjes. Parimi i mos diskriminimit në procedurën administrative, duhet të përcaktohet edhe rregulloret e ZRRE për procedurën e dhënies së licencave.

E Drejta e ankesës. Kjo përbën një obligim kushtetues. Sistemi i shqyrtimit të licencave në ZRRE si dhe procedurat për këtë, nuk parashohin të drejtën e ankesës në rast të refuzimit. Neni 34 i Ligjit për ZRRE përcakton vetëm procedurën e ri aplikimit për licencë pas 60 ditësh dhe jo të drejtën e ankesës, pas refuzimit. Një gjë e tillë nuk përcaktohet as në Rregulloren për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë ZRRE/Nr. 07/2017. Andaj, ZRRE duhet të shikojë mundësinë që të përcaktojë me rregullore një procedurë të ankesës për mos licencim. E drejta për refuzimin e licencës ose lejimit përcaktohet edhe me LSSL, respektivisht nenin 27. ZRRE duhet të krijojë një mekanizëm juridik, përmes rregulloreve në të cilën adresohen ankesat për mos licencim. Për të përmbushur këtë rekomandim, ZRRE duhet të krijojë një komision të ankesave që adreson aspektin e mos licencimit dhe ku palët kanë të drejtë ta ankohen vetëm kur ndodh mos licencimi. Kjo duhet të bëhet duke ndryshuar aktet nënligjore dhe rregulloret në fuqi, **Rregullorja për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë ZRRE/Nr. 07/2017; rregulla për taksat Nr.01/2020; Rregulla - ZRRE/Nr. 03/2022 për procedurën e autorizimit për ndërtimin e projekteve të energjisë,** ku do të parashihet një komision i veçantë për ankesa në rast të mos licencimit.

Pagesa e taksave të shumëfishta. LSSL përcakton një taksë proporcionale, për aq sa ajo është e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar lejimin. Në anën tjetër, LPPA përcakton mos pagesën e procedurës dhe sipas kësaj kjo pagesë mund të bëhet vetëm në raste kur përcaktohet ndryshëm me ligj. Në rastin e ZRRE, Neni 23 i ligjit për ZRRE përcakton llojet e taksave: *taksa për modifikimin dhe ndryshimin e licencave si dhe aplikacionet tjera për licenca; taksa fillestare dhe vjetore të licencimit; taksa për lëshimin e certifikatave të origjinës; dhe shqyrtimi/rishikimi i aplikacioneve për autorizim dhe licencim.*

Neni 24.5 i ligjit për ZRRE përcakton: **“Me përjashtim të taksave vjetore, taksat e vëna në bazë të këtij neni do të llogariten në pajtim me shpenzimet specifike administrative të arsyeshme të shkaktuara në trajtimin e akteve të cilat u referohen taksat e tilla”.** Kjo nënkupton që ZRRE ka obligim që këto taksa, sidomos ato të aplikimit t’i llogaris në proporcion me shpenzimet administrative. ZRRE taksat vjetore i llogarit si taksa të mirëmbajtjes së licencës dhe ato shërbejnë për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të ZRRE, për shkak se ndërmarrjet e licencuara gjenerojnë të hyra nga veprimtaritë që licencohen nga ZRRE.

Taksat e shqyrtimit të licencës paguhen në momentin e shqyrtimit të aplikacionit. Megjithatë për të lehtësuar çështjen e veprimtarisë së të licencuarve por edhe të licencuarve, ZRRE ka krijuar forma alternative të pagesës në llogarinë e tyre, duke përfshirë edhe mundësinë e pagesës me E-Banking, mirëpo për të aplikuar këtë formë të pagesës duhet të ndryshojë nenin 13 të rregullores për taksat Nr.01/2020, që përcakton mënyrën e pagesës dhe ku përcaktohet që palëve i pranohen edhe pagesat elektronike. Gjithashtu ZRRE, duhet të bëjë një përllogaritje të saktë të proporcionalitetit të taksës së aplikimit, duke llogaritur shpenzimet përkatëse që i ka pala në procedurë dhe pagesën përfundimtare për taksën e aplikimit. Deri tani një përllogaritje e tillë mungon.

Parimi i një sporteli të vetëm (pikat e vetme të kontaktit), është obligim ligjor i përcaktuar si në LSSL, respektivisht nenin 16 ashtu edhe në LPPA si dhe LPPA nenin 33. Sipas këtij parimi të gjitha formalitetet dhe procedurat për lëshimin e një leje dhe licence duhet të kryhen përmes PKV të kontaktit (one stop shop). Të dyja ligjet lejnë hapësirë që PKV të krijohen në mënyrë fizike, elektronike apo të kombinuara. Parakusht kryesor për t'i krijuar PKV janë pikat që i cekëm më lartë, sidomos qasja e orientuar nga parimi i shqyrtimit administrativ sipas detyrës zyrtare. Në ZRRE nuk ekziston asnjë lloj tipi i PKV prandaj edhe licencat jepen ndaras nga secili organ publik që nënkupton se pala vet i kryen të gjitha formalitetet dhe procedurat që nëse do të ekzistonte PKV mund të kryheshin përmes saj nga vet organi publik. Deri tani në ZRRE mungon një pikë e vetme e kontaktit dhe e cila do të lehtësonte barrën administrative të palës, me rastin e aplikimit. ZRRE duhet të veprojë për të krijuar një mekanizëm të tillë.

Parimi i aplikimit të ndihmës administrative. Neni 34 i LPPA përcakton se organi publik mund të kërkojë ndihmë nga një organ tjetër publik, ndër të tjera për njohjen me fakte, dokumente apo mjete të tjera të provës në posedim të organit tjetër. Ky parim mund të përdoret për të lehtësuar procedurën e verifikimit të dokumenteve të nevojshme. ZRRE në rastin e shqyrtimit të procedurës së lejeve dhe licencave nuk e aplikon fare parimin e ndihmës juridike. ZRRE është i obliguar që në procedurën e aplikimit dhe lëshimit të licencave, të përdorë më shumë parimin e ndihmës administrative, duke kërkuar ndihmë nga organet e tjera, për të ofruar informacione dhe verifikimin e disa dokumenteve të caktuara, pa pasur nevojë ato të kërkojnë nga pala.

Shqyrtimi i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare. Këtë parim e lejon neni 86 i LPPA. Në fakt ky parim në dritën e lehtësimit të procedurave për dhënin e licencave në ZRRE, bazuar mënyrën se si rregullohet procedura e licencimit në ZRRE duhet të kombinohet me parimin e aplikimit të ndihmës administrative. ZRRE nuk aplikon fare parimin e zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, pasi që për plotësimin e aplikacionit, në rast se dokumentet nuk janë dorëzuar, bazuar në Rregulloren për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë ZRRE/Nr. 07/2017, neni 5 paragrafët 3 dhe 5 duhet të plotësojnë aplikacionin, në rast të mungesave të dokumentacionit. Neni 86.3 i LPPA, në lidhje me këtë parim përcakton: **“Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, dokumentet që vërtetojnë akte, fakte, cilësi apo gjendje subjektive, të nevojshme për shqyrtimin administrativ, administrohen, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që zhvillon procedurën administrative, nëse janë në administrim të tij apo të organeve të tjera publike. Organi publik mund t’i kërkojë palës vetëm informatat e nevojshme për identifikimin e tyre”**. Kjo nënkupton që në disa raste, kur dokumentet dhe kushtet e dokumentacionit për një licencë, nuk përcaktohen me ligj, atëherë ZRRE në rastin konkret mund të kërkojë nga pala që vetëm të evidentojë që disa dokumente ekzistojnë dhe të njëjtat t’i verifikoj, nëse ato ekzistojnë në organet publike. Pra ZRRE të veprojë sipas detyrës zyrtare, për të verifikuar një numër të caktuar të dokumenteve.

E Drejta për të ofruar mendime, shpjegime dhe prova: Neni 94 i LPPA i lejon palës që përgjatë shqyrtimit dhe zhvillimit të procedurës të ofrojë prova dhe të sqarojë çështjet deri në vendosjen përfundimtare. Në rastin e ZRRE po ashtu ky parim nuk aplikohet fare, për shkak se në rast se aplikuesi nuk dorëzon dokumentet e munguara, atëherë aplikacioni i tij/saj refuzohet. Andaj në rastin e ZRRE, ky parim mund të zbatohet lehtësisht, përmes ndryshimit të rregullores për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë ZRRE/Nr. 07/2017. Palës sipas rregulloreve duhet ti lejohet që të ofrojnë sqarime shtesë në çdo kohë, për dokumentacionin që ofron dhe aplikacionin për licencë.

Zhvillimi i procedurës së shqyrtimit në mënyrë elektronike. Neni 14.2. i LSSL përcakton: “Çdo autoritet kompetent duhet ta bëjë të mundur për një person që aplikacionin për lejim ta bëjë në mënyrë elektronike”. Kjo krijon mundësinë që bazë të akteve të brendshme që nxjerr ZRRE për licencimin të mundësojë zhvillimin e një procedure të shqyrtimit në mënyrë elektronike. Kjo është e mundur pasi që nenin 17.2 i LSSL lejon që procedurat e aplikimit të licencës të bëhen me akt nënligjor, që në rastin e ZRRE kjo nënkupton që nuk ka nevojë të bëhen ndryshime ligjore lidhur me zhvillimin e një procedure elektronike. Duhet theksuar që ZRRE i pranon aplikacionet në mënyrë elektronike, por kjo duhet që të theksohet edhe në rregulloret e brendshme, si procedurë e ndarë nga aplikimi fizik duke i ndryshuar aktet nënligjore.

Kushtet dhe kriteret specifike për dhënien e licencave. ZRRE përbën një rast të operimit me kushte të licencave dhe lejimeve tjera tejet specifike. Neni 30 i Ligjit për ZRRE përcakton kushtet për licenca në ZRRE. Kushtet specifike që përcaktohen në nenin 30, pastaj janë konkretizuar me rregulloren e ZRRE të rregulloren për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë ZRRE/Nr. 07/2017. Në rastin e ZRRE, dokumentet e nevojshme për një licencë, janë mjaft specifike sepse ndërlidhen edhe me: *mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë publike; mbrojtjen e mjedisit; shfrytëzimin e tokës dhe vendndodhjen; shfrytëzimin e tokës publike; eficiencën e energjisë; natyrën e burimeve primare të energjisë; karakteristikat e veçanta të aplikantit siç janë: aftësitë teknike, ekonomike dhe financiare.* Duke marrë parasysh specifikat e licencave të ZRRE, atëherë në disa raste edhe dokumentacioni është specifik. Andaj, në bazë të analizës, reduktimi i dokumentacionit është kërkuar rast pas rasti, bazuar në dy alternativa: 1. Verifikimi i disa fakteve përmes deklaratës nën betim dhe 2. Identifikimi nga pala e disa dokumenteve si dhe veprimi i ZRRE, sipas parimit të ndihmës administrative dhe zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare që përcaktohen në LPPA.

Dorëzimi dokumentacionit në origjinal si një karakteristikë e ZRRE-Në kuadër të lejimeve që miraton ZRRE, ka një fenomen bazuar në RQLL dhe ky fenomen ka të bëjë me dorëzimin e disa dokumenteve në origjinal, përfshirë edhe ato dokumente që përbejnë fakte notore dhe madje të pakontestueshme, siç është certifikata e regjistrimit të biznesit ose dëshmitë tjera për themelimin e shoqatës ose konzerciumit (varësisht nga lloji i lejit) ose statuti i saj, etj. Andaj, ngritja e këtij parimi është bërë me qëllim që një gjë e tillë të konkretizohet tek rekomandimet e veçanta, të përcaktuara në shtojcën e kësaj analize.

3. Analiza ligjore përkitazi me harmonizimin e lejeve dhe licencave me kriteret e LSSL

Harmonizimi nën dritën e qëllimit të këtij raporti, nënkupton një proces të përshtatshmërisë së LSSL në rastin konkret dhe LZRRE, me qëllim të përcaktimit të lejeve dhe licencave që lëshon ZRRE, bazuar LSSL. Lidhur me aspektin e harmonizimit janë me rëndësi të evidentojmë çështjet si në vijim:

Përcaktimi i lejeve dhe licencave me ligj. Ky parim përcaktohet në nenin 17.1 të LSSL dhe si i tillë nënkupton që leja dhe licenca, qoftë edhe në kuptimin e emërimit të përcaktohet me ligj. Në rastin e ZRRE, ligji ndjek një logjikë tjetër, duke përcaktuar vetëm aktivitetet për të cilat lëshohen licencat në ZRRE dhe nuk i përcakton me ligj llojet e lejeve dhe licencave. Neni 28 i Ligjit për ZRRE ka përcaktuar veprimtaritë për të cilat përcaktohen licencat e lëshuar nga ZRRE. Gjithashtu edhe përsa i përket autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja, të cilat janë licenca të lëshuara nga ZRRE dhe njihen me nenin 43, në këtë ligj nuk përcaktohet se cilat lloje të autorizimeve mund të lëshohen nga ana e ZRRE. Andaj, në pajtim me parimin që lejet dhe licencat, sipas emërimit të përcaktohen me ligj, duhet të shikohet mundësia që në ligjin për ZRRE, respektivisht në nenin 29 dhe në neni 43, por edhe duke krijuar një nen të ri, të përcaktohen llojet e licencave dhe autorizimeve që lëshohen nga ZRRE, me emërtim të saj, bazuar në veprimtaritë që i lejon aktualisht ligji për ZRRE dhe ligjet e tjera të aplikueshme nga ZRRE.

Emërtimet e lejeve dhe licencave të përcaktohen me ligj: Kjo kërkon që të gjitha lejet dhe licencat që lëshon ZRRE, si: licenca, autorizime dhe aprovime tjera, të përcaktohen me ligjin për ZRRE, sipas emërimeve aktuale që i kanë. Për këtë duhet të krijohet një bazë ligjore, pas nenit 30 të LZRRE ose të krijohet një nen i ri që do të përfshinte veçanërisht harmonizimin e nenit 28, 30 dhe 43 të LZRRE.

Krijimi i lejeve dhe licencave të ZRRE sipas nenit 5 të LSSL: Neni 5 i LSSL përcakton llojet e lejimeve të cilat janë: njoftim, regjistrim, leje dhe licenca profesionale. Në këtë rast edhe emërtimet e lejimeve që i bën ZRRE duhet t'i përshtaten këtij. Kjo nënkupton që nenet e LZRRE, si neni 28, 30, 43 etj, duhet të harmonizohen me nenin 5 të LSSL. ZRRE në kuptim të këtij neni, duhet që të kategorizojë të gjitha lejet dhe licencat, sipas nivelit të rrezikut, bazuar në nenin 5 të LSSL. Për këtë arsye duhet të ndryshohet në tërësi nenet 28, 30 dhe 43 të LZRRE, në mënyrë që emërtimet të përshtaten me nenin 5 të LSSL, duke marrë parasysh nivelin e rrezikut.

Kategorizimi i lejeve dhe licencave sipas rrezikut: LZRRE duhet të përcaktojë një sistem të kategorizimit të lejeve dhe licencave, sipas rrezikut, sikurse e përcakton edhe neni 19 i LSSL. Për këtë duhet të plotësohet ose duhet të krijohet një nen i ri në LZRRE, pas nenit 28.

4. Të gjeturat

1. Ligji për LSSL të “të licencuarit” i referohet vetëm personit fizik, kurse Ligji për ZRRE dhe ligjet e tjera të aplikueshme, me “të licencuar” nënkuptojnë edhe ndërmarrjet si persona juridik.
2. Të gjitha licencat e ZRRE janë me afat të caktuar sipas kategorive, ndërsa LSSL, nuk rregullon çështjen e ri licencimit ose vazhdimit të licencës.
3. Nuk përcaktohet një procedurë e ankesës për mos licencim në ZRRE.
4. Nuk ka një pikë të vetme të kontaktit në ZRRE, përkitazi me aplikimin për licenca dhe lejime të tjera.
5. Nuk zbatohet parimi i ndihmës administrative për të lehtësuar procedurën e verifikimit të dokumenteve të nevojshme që dorëzohen për licencë.
6. Nuk zbatohet parimi i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, për verifikimin e dokumenteve të identifikuar nga palët, që i posedojnë institucionet publike.
7. Nuk i mundësohet që të sjellë edhe dokumentacionin shtesë, për kërkesën e tij por aplikacioni për leje dhe licencë vetëm refuzohet, sipas LPPA dhe rregulloret të ZRRE.
8. Nuk përcaktohet procedura elektronike si rregull por vetëm si përjashtim. Kjo duhet të reflektohet në rregulloret e ZRRE
9. Disa dokumente që janë notore dhe mund të vërtetohen lehtësisht, me rastin e aplikimit për licencë kërkohen të dorëzohen në origjinal.
10. Një numër i dokumenteve që kërkohen tek kategoria e kërkesave të përgjithshme, duken që shtojnë barrën administrative për mënyrën se si kërkohen.
11. Në ZRRE ka leje dhe licenca që nuk përcaktohen shprehimisht me ligj, sipas emërimit të tyre aktual.

5. Rekomandimet kryesore

1. Të rregullohet më specifikisht, se kush mund të aplikojë për licencë dhe për cilat licenca (person fizik ose juridik);
2. Të krijohet bazë e qartë ligjore për licencat ekzistuese të ZRRE;
3. Të zgjatet afati i dhënies së licencës nga ZRRE, respektivisht të përcaktohet një afat minimal për kategoritë e licencave;
4. Të bëhet harmonizimi i ligjit për ZRRE, respektivisht plotësimi i nenit 29 të Ligjit, në kuptimin e emërimit të licencave nga ZRRE, për veprimtaritë që nuk kërkojnë licencë, bazuar në nenin 5 të LSSL.
5. Të përcaktohet procedura e ankesës për rast të mos licencimit;
6. Të krijohet një PKV në ZRRE;
7. Të zhvillohet procedurë elektronike për aplikim dhe shqyrtim të licencave dhe të mos jetë domosdoshmëri vetëm aplikimi në kopje fizike;
8. Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuptim të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike;
9. Të bëhet ripërtëritja e licencave sipas parimit ex officio;

10. Të verifikohen disa dokumente të nevojshme sipas deklaratës nën betim;
11. Pagesa e taksave fillestare të shqyrtimit të bëhet pas aprovimit të kërkesës dhe të rishikohet taksa e rishikimit të licencës me kërkesë të ZRRE;
12. Ti mundësohet palës që të ofrojë dëshmi e prova shtesë, përgjatë shqyrtimit të procedurës, deri në afatin e fundit të vendosjes;
13. Të bëhet lirimi nga taksa, në rast të modifikimit të licencës me iniciativë të ZRRE;
14. Të bëhet harmonizimi LZRRE dhe LSSL, sipas parimeve të përcaktuara;
15. Të aplikohet afati 45 ditor i vendosjes për kërkesat për leje dhe licenca, sipas LPPA.

6.Arsyetime i rekomandimeve kryesore

1.Të rregullohet më specifikisht, se kush mund të aplikojë për licencë dhe për cilat licenca (person fizik ose juridik). Ky rekomandim është dhënë për arsye se në Ligjin për ZRRE nuk përcaktohet statusi të licencuarit, pra në kuptimin se a do të jetë person fizik ose juridik. Ligji Për Energjinë Elektrike në anën tjetër, në nenin 1.21 si “i licencuar” i referohet personit, kurse në nenin 1.46 “ndërmarrjes së energjisë elektrike” i referohet si pëson fizik ose juridik, që mund të kryej një ose më shumë veprimtari që kërkojnë licencë. Në këtë kuptim, bazuar në nenin 17.2 të LSSL, ZRRE duhet ta vlerësojë seriozisht që të përcaktojë qartësisht se cilat lejime, leje dhe licenca mund ti lëshojë për persona fizik e cilat për persona juridik, me qëllim që të bëhet harmonizimi me LSSL. Specifikimi duhet të bëhet përmes ndryshimit të akteve nënligjore, respektivisht: Rregullorja për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë ZRRE/Nr. 07/2017; rregulla për taksat Nr.01/2020; Rregulla - ZRRE/Nr. 03/2022 për procedurën e autorizimit për ndërtimin e projekteve të energjisë.

2.Të krijohet bazë e qartë ligjore për licencat ekzistuese të ZRRE. Bazuar në nenin 17.2 të LSSL lejet dhe licencat përcaktohen vetëm me ligj. Në rastin konkret të ZRRE janë të përcaktuara veprimtaritë që duhet të kenë licencë. Në anën tjetër, sa i përket autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja, si lejime, nuk përcaktohet një bazë konkrete ligjore e lejes ose licencës, sipas emërimit. Rekomandimet e veçanta për këtë çështje janë dhënë në kuadër të shtojcës.

3.Të zgjatet afati i dhënies së licencës nga ZRRE, respektivisht të përcaktohet një afat minimal për kategoritë e licencave. Afatet sipas ligjit për ZRRE, ndahen në kategori dhe ZRRE vendos zakonisht duke vlerësuar kriteret e caktuara, siç janë jetëgjatësia e aseteve dhe gjendja financiare e aplikuesit. Në kontekst të kësaj, për të lehtësuar barrën administrative të aplikuesve, për disa kategori të licencave, siç janë autorizimet duhet të rritet kohëzgjatja e afatit, si kur është fjala për pragun minimal ashtu edhe për atë maksimal. Po ashtu, ZRRE për secilin rast, përsa i takon afatit duhet të caktoj një minimum të zgjatjes së tij, psh sikur në rastet kur kohëzgjatja mund të jetë 40, 30 apo 25 vite, në këto raste duhet të duhet të ketë edhe një minimum të kohëzgjatjes për këto kategori, e cila duhet të bëhet me ligj. Sqarime të tjera konkrete janë dhënë në shtojcën e këtij raporti.

4.Rastet kur nuk kërkohet licencë të emërtohen sipas LSSL. Në nenin 5 të LSSL përcakton llojet e lejimeve. Në anën tjetër Ligji për ZRRE përcakton kriteret për lejimet që nuk kërkojnë licencë, por megjithatë kalojnë në procedurë të miratimit. Andaj, një gjë e tillë duhet të bëhet sipas emërtimeve që i ka përcaktua neni 5 i LSSL, si njoftim, regjistrim leje etj. Për këtë duhet të bëhet ndryshimi dhe harmonizimi i nenit 5 të LSSL dhe nenit 28 të LZRRE.

5.Të përcaktohet procedura e ankesës për rast të mos licencimit. Në kuadër të ligjit, por as rregullat përkatëse, që vlejné për procedurën e dhënies së lejimeve në kuadër të ZRRE, nuk kanë përcaktuar një afat ankese për çështjen e refuzimit të licencimit ose vazhdimin të licencës. Për të respektuar të drejtat e palës duhet të krijohet një mekanizëm i ankesës, sipas parimeve të përcaktuara në LPPA dhe kjo mund të bëhet përmes rregullave që i miraton ZRRE. Duhet të ndryshohen Rregullorja për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë ZRRE/Nr. 07/2017; rregulla për taksat Nr.01/2020; Rregulla - ZRRE/Nr. 03/2022 për procedurën e autorizimit për ndërtimin e projekteve të energjisë për të krijuar një mekanizëm të ankesës, në rastin e refuzimit për të licencave.

6.Të krijohet një PKV në ZRRE. Një sportel i vetëm apo pikë e vetme e kontaktit duhet të krijohet në ZRRE, përse i takon procedurës së aplikimit dhe shqyrtimit të licencave dhe lejeve tjera të ZRRE. Kjo pikë e vetme e kontaktit do të lehtësojë procedurën dhe do të koncentrojë kapacitetet shqyrtuese në këtë pikë. Po ashtu një gjë e tillë do të ndihmojë aplikuesit që në mënyrë efikase të fillojnë dhe përfundojnë procedurën si dhe gjithashtu, kjo do t'i ndihmojë edhe organin që më lehtësisht të shqyrtoj aplikimin. PKV duhet të veprojë edhe me rastin e ndryshimit të licencës apo lejit si dhe procedurat e tjera të ankesës në procedurë të shqyrtimit etj.

7.Të zhvillohet procedurë elektronike për aplikim dhe shqyrtim të licencave dhe të mos jetë domosdoshmëri vetëm aplikimi në kopje fizike. Procedura elektronike e shqyrtimit të lejeve dhe licencave lehtëson jashtëzakonisht shumë aplikimin dhe shqyrtimin e licencave dhe lejeve në ZRRE. Me krijimin e pikave të vetme të kontaktit mund të krijohet edhe një databaza, ose formë e aplikimit elektronik. ZRRE duhet të aplikojë mundësinë që vetëm dokumentet që duhet domosdoshmërisht për verifikim të dërgohen nga pala si dokumente fizike ose origjinale. Procedura elektronike mund të caktohet me rregulla të brendshme të ZRRE.

8.Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuptim të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike. ZRRE duhet të aplikojë parimin e ndihmës administrative, përgjatë zhvillimit të procedurës dhe këtë ta bëjë të kombinuar me parimin e zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare. Përmes aplikimit të këtij parimi, ZRRE do të verifikojmë një numër të dëshmimeve, të cilat nevojiten që të dorëzohen nga pala me parashtrimin e kërkesës. Përmes aplikimit të këtyre parimeve, ZRRE do të shmang dorëzimin e disa dokumenteve, me rastin e aplikimit të palëve për leje dhe licenca. Kjo nënkupton që vetë organi, pra ZRRE, për një pjesë të dokumentacionit të verifikojë dokumentin sipas detyrës zyrtare, duke mos e ngarkuar palën që aplikon.

9.Të bëhet ripërtërja e licencave sipas parimit ex officio. Me rastin e ripërtërjes së licencës, sidomos kur këtë e kërkon ZRRE, procedura e verifikimit të fillohet dhe të përfundohet duke respektuar veprimin e ndërmarrjes së procedurave sipas detyrës zyrtare. Ky parim do të vinte në shprehje edhe me rastin e ripërtërjes së licencës si dhe modifikimit të saj. Sipas rekomandimit, ZRRE duhet të veprojë sipas detyrës zyrtare dhe të verifikojë disa dokumente, në mënyrë që palëve të ja lehtësojë barrën administrative.

10.Të verifikohen disa dokumente të nevojshme sipas deklaratës nën betim. Disa dokumente të nevojshme me rastin e aplikimit për licenca dhe leje në ZRRE rekomandohet të reduktohen, për të lehtësuar barrën administrative. Reduktimi i këtyre dokumenteve mund të bëhet në atë mënyrë që disa çështje që duhet të jenë pjesë e aplikacionit, të vërtetohen përmes deklaratës nën betim, duke pasur parasysh faktin që sipas ligjit për ZRRE licenca mund të tërhiqet në rast se aplikuesi ofron të dhëna të pa vërteta.

11.Pagesa e taksave fillestare të shqyrtimit të bëhet pas aprovimit të kërkesës. Duke pasur parasysh pagesën e taksave dhe faktin që këto taksave janë të llogaritura në bazë të parimit e llogaritjes në pajtim me shpenzimet specifike administrative të arsyeshme të shkaktuara në trajtimin e akteve të cilat u referohen taksat e tilla. Për të lehtësuar barrën administrative, taksa fillestare duhet të paguhet në mënyrë elektronike si dhe pasi që të miratohet kërkesa e aplikuesit. ZRRE obligohet që të bëjë përlllogaritjen në raport me shpenzimet.

12.T'i mundësohet palës që të ofrojë dëshmi e prova shtesë, përgjatë shqyrtimit të procedurës, deri në afatin e fundit të vendosjes. Në bazë të parimit të dëgjimit të palës, për të lehtësuar qasjen e aplikuesve, ZRRE duhet të lejojë plotësimin e dokumentacionit për aplikuesin, deri në përfundimin e afatit të shqyrtimit të licencës. Kjo do t'i ndihmojë palës që të ketë qasje më të lehtë në aplikimin dhe shqyrtimin e licencës ose lejit si dhe lejon ZRRE.

13.Të bëhet lirimi nga taksa, në rast të modifikimit të licencës me iniciativë të ZRRE. Në rast të modifikimit të licencës, me kërkesë të ZRRE, është barrë administrative që pala të paguaj taksë në rastin e modifikimit. Andaj, duhet të vendoset që të ndryshohet rregullorja dhe në pajtim me parimin e

proporcionalitetit, pala nuk duhet të ngarkohet me pagesat e taksës, në rast të modifikimit me iniciativë të ZRRE.

14.Të bëhet harmonizimi LZRRE dhe LSSL, sipas parimeve të përcaktuara. Në disa aspekte LSSL ka nevojë të harmonizohet me ZRRE, bazuar në parimet dhe të gjeturat respektive të këtij raporti, sipas të gjeturave kryesore përkitazi me harmonizimin si dhe të gjeturat dhe rekomandimet e veçanta.

15.Të aplikohet afati 45 ditor i vendosjes për kërkesat për leje dhe licenca, sipas LPPA-ZRRE në të gjitha rastet e vendosjes, ZRRE aplikon afatin e për vendosje lidhur me kërkesën për leje dhe licencë në kohëzgjatje prej 90 ditësh. Me qëllim të lehtësimit të procedurës dhe barrës administrative, ZRRE duhet të aplikojë afatin e vendosjes për kërkesën për leje dhe licencë, prej 45 ditësh, në pajtim me kërkesat e LPPA. Aplikimi i afatit 45 ditor do të zvogëlonte kohëzgjatjen e vendosjes dhe do të rriste efikasitetin si dhe lehtësonte barrën administrative të palës. Kjo vlen vetëm për licencat, në të cilat afati i aplikueshëm është 60 ditë.

7.Zbatimi i rekomandimeve të përgjithshme dhe të veçanta

Në kuadër të raportit, siç u theksua janë dhënë rekomandimet e përgjithshme dhe ato të veçanta, të paraqitura në shtojcë për secilën licencë. Duhet konstatuar, se për shkak të faktit se LZRRE njih dy kategori të lejimeve, respektivisht licencë dhe autorizim, rekomandimet e veçanta në shtojcë, për licenca dhe autorizime kanë rezultuar të jenë të njëjta. Një gjë e tillë ka ardhur në shprehje për faktin se të gjitha licencat në ZRRE, lëshohen sipas bazës së njëjtë ligjore, me afat të kohëzgjatjes së përafërt dhe dokumente të nevojshme për lëshimin e tyre të përafërta. E njëjta gjë vlen në shprehje edhe me autorizimet, si kategori e lejimeve në ZRRE.

Zbatimi i rekomandimeve të përgjithshme dhe të veçanta, sipas shtojcës mund të bëhet në dy mënyrë dhe atë: 1.Përmes të plotësimeve dhe ndryshimeve të LZRRE dhe 2.Përmes plotësimeve dhe ndryshimeve të rregulloreve të brendshme të ZRRE, për rregullimin e procedurave për lëshimin e licencave dhe autorizimeve të ZRRE.

SHTOJCA

Në shtojcë janë përfshirë lejet dhe licencat e lëshuara nga ZRRE, sipas renditjes në RQLL

1.AUTORIZIM PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE TË REJA NGA ERA

1.Të gjeturat kryesore

1.1 Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës:

Neni 15 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084 përcakton detyrat e këtij rregullatori ndër të tjera: “1. **Për përmbushjen e detyrave, Rregullatori ka autoritetin dhe përgjegjësitë në vijim: 1.15. të lehtësojë qasje në rrjet për kapacitetet e reja prodhuese, në veçanti duke i larguar barrierat të cilat do të mund t’ua pamundësonin qasjen në treg palëve të reja nga burimet e ripërtëritshme të energjisë.** Në kuptim të nenin 15 par.1.15 të Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë ky lloji i licencës, i titulluar autorizim ka të bëjë me fushëveprimin e rregullatorit të energjisë për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese. Baza konkrete ligjore për dhënien e këtij lejimi (licence) paraqitet në nenin 43 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084. Ky nen njeh dhënien e autorizimeve si lejime, për ndërtimin e kapaciteteve të reja. Neni 43.1 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084 përcakton: “1. **Ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese, sistemeve të reja për bartjen dhe shpërndarjen e gazit natyror, përfshirë interkonektorët, si dhe linjat direkte elektrike dhe gazsjellësit direkt për bartjen e gazit natyror do të bëhet në pajtim me procedurat e autorizimit sipas këtij ligji, përveç në rastet kur paragrafit 1 i nenit 44 të këtij ligji shprehimisht lejon përdorimin e procedurës së tenderimit**”. Megjithatë, vetëm pjesa e parë e nenit 23 flet për bazën ligjore konkrete, andaj është e udhës që baza për këtë lloj lejimi të jetë më specifike dhe konkrete, sipas emërimit dhe qëllimit për të cilin lëshohet.

1.2 Veprimtaria për të cilën lëshohet leja/licenca:

Qëllimi i kësaj procedure është ndërtimi i kapaciteteve të reja për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme.

1.3 Vlefshmëria kohore e lejes/licencës:

Nga praktika e lëshimit të këtij lloji autorizimi (psh rasti i vendimit: V 1211, 2.11.2019), ky lloj autorizimi është lëshuar sipas planit dinamik të aplikuarit, respektivisht për 3 vite e katër muaj.

1.4 Pagesa për pajisjen me leje/licencë:

Pagesa e taksës për licencë 1000 euro. Rishikim ndryshim dhe modifikim i autorizimit 500 Euro.

1.5 Dokumentet e nevojshme për aplikim:	Rekomandimet për zvogëlimin e barrës administrative, sipas LPA
1. Certifikatën e biznesit të lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Biznesit në Kosovë, duke përfshirë vendimin e bordit të kompanisë për përfaqësuesin e autorizuar për Aplikim	Duhet të vërtetohet nga ARBK, me kërkesë të ZRRE, sipas parimit të veprimit ex officio dhe ndihmës administrative. Pala vetëm duhet të konfirmoj që e posedon këtë dokument

2. Dëshmi mbi mundësitë financiare të Aplikuesit, dhe të kompanisë amë, duke përfshirë raportet financiare, siç kërkohen me ligjin për Kontabilitetin, Raportet Financiare dhe Auditimin, varësisht nga klasifikimi i ndërmarrjes;	Të dorëzohet nga pala
3. Dëshmi mbi kapacitetin financiar sipas Nenit 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 nënkuptoj se Aplikuesi posedon të paktën dhjetë (10%) përqind të vlerës së investimit. Kjo dëshmi duhet të mbështetet me deklaratë bankare të lëshuara jo më herët se pesë (5) ditë nga data e Aplikimit.	Të dorëzohet nga pala
4. Certifikatën e solvencës të biznesit të Aplikuesit, duke përfshirë edhe certifikatën e solvencës së biznesit të kompanisë amë, e lëshuar nga gjykata kompetente, ku dëshmohet se Aplikuesi apo kompania amë nuk është në falimentim;	ZRRE ta kërkojë këtë dokument nga KGJK, bazuar në parimin e ndihmës administrative dhe veprimit sipas detyrës zyrtare. Pala vetëm duhet të konfirmoj që e posedon këtë dokument.
5. Dëshmi nga organet tatimore se Aplikuesi, përfshirë kompaninë amë, nuk ka obligime tatimore;	ZRRE ta kërkojë këtë dokument nga Administrata Tatimore, bazuar në parimin e ndihmës administrative dhe veprimit sipas detyrës zyrtare. Pala vetëm duhet të konfirmoj që e posedon këtë dokument.
6. Dëshmi mbi të drejtat pronësore dhe ligjore të pronës ku do të ndërtohen Kapacitetet e Reja Gjeneruese;	Ky dokument të dorëzohet nga pala.
7. Studimi i fizibilitetit teknik dhe financiar, për projekt me kapacitet të instaluar mbi 1 MË;	Ky dokument duhet të dorëzohet nga pala.
8. Parakontrata ose Kontrata për Projektim, Prokurim dhe Ndërtim (EPC);	Ky dokument duhet të dorëzohet nga pala.
9. Plani i biznesit që përmban parametrat teknikë të projektit dhe planin financiar që përshkruan mënyrën e financimit, duke përfshirë koston totale të investimit dhe mënyrën e financimit; vlerësimin ekonomik dhe financiar të projektit duke përfshirë pasqyrat financiare; vlerësimin statik dhe dinamik të investimit (PBP, NPV, IRR dhe BP);	Ky dokument duhet të dorëzohet nga pala.
10. Akti komunal që konfirmon se Projekti Energjetik i propozuar është i lejuar sipas planeve zhvillimore ose hapësinore të Komunës;	Ky dokument duhet të dorëzohet nga pala.

11. Marrëveshja për kyçje me operatorin përkatës të sistemit;	Ky dokument duhet të dorëzohet nga pala.
12. Pëlqimin Mjedisor të lëshuar nga autoriteti përkatës, nëse kërkohet për projektin në fjalë;	ZRRE ta kërkojë këtë dokument nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), bazuar në parimin e ndihmës administrative dhe veprimit sipas detyrës zyrtare. Pala vetëm duhet të konfirmoj që e posedon këtë dokument.
13. Të drejtat Ujore nëse për projektin në fjalë kërkohet leja ujore në bazë të ligjit për Ujërat e Kosovës;	Ky dokument duhet të dorëzohet nga pala.
14. Lejen e ndërtimit të lëshuar nga Ministria përgjegjëse për ndërtim ose nga Komuna përkatëse, varësisht prej autoritetit që lëshon lejen sipas Ligjit të Ndërtimit.	Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) ose komuna, bazuar në parimin e ndihmës administrative dhe veprimit sipas detyrës zyrtare. Pala vetëm duhet të konfirmoj që e posedon këtë dokument.

2.Rekomandimet

1. Të bëhet ndryshimi i nenit 43 të Ligjit për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, në mënyrë që ky lloj i autorizimit të përcaktohet në mënyrë specifike.
2. Të zgjatet afati për këtë lloji të autorizimit.
3. Disa dokumente të nevojshme për aplikim për këtë autorizim të vërtetohen sipas parimit të ndihmës së organeve administrative dhe veprimit ex officio ose të identifikohen sipas deklaratës nën betim.
4. Taksa për autorizimin të paguhet në rast të miratimit të kërkesës dhe nxjerrjes së vendimit për miratim.
5. Të përcaktohet saktësisht nëse për këtë autorizim mund të aplikojnë personat fizik.
6. Publikimi i njoftimit sipas nenit 13 të rregullës - ZRRE/Nr. 03/2022, të behët nga ZRRE në ueb faqe.
7. Dorëzimi i sqarimeve nga pala të bëhet deri në momentin e marrjes së vendimit përfundimtar, brenda afatit maksimal të shqyrtimit 90 ditë, duke ndryshuar nenin 14.2 të rregullës - ZRRE/Nr. 03/2022.
8. Të ndryshohen nenin 9 dhe 10 i Rregullës - ZRRE/Nr. 03/2022, për shkak se llojet e licencave duhet të përcaktohen me ligj.

3.Arsyetimi i rekomandimeve

1.Në kuptim të nenit 43 të Ligjit për ZRRE, emërtimi i këtij lloji të autorizimit si Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja nga era, nuk është i përcaktuar me ligj. Neni 43 i Ligjit për ZRRE, përcakton vetëm mundësinë e ndërtimit të kapaciteteve të reja, pa specifikuar llojet e energjisë së ripërtitshme, edhe pse të njëjtat përmenden në ligjet e veçanta. Megjithatë në Ligjin për ZRRE duhet të përcaktohet emërtimi i plotë i llojeve të autorizimeve që lëshon ZRRE, në bazë të ligjeve të veçanta që i zbaton ZRRE siç janë: Ligjin Nr. 05/L – 085 për Energjinë; Ligji Nr. 05/L – 085 për Energjinë Elektrike; Ligji Nr. 05/L-082 për Gazin

Natyror; Ligjit Nr. 05/L -052 për Energjinë Termike. Për të pasur bazën konkrete ligjore, duhet të ndryshohet neni 43 i Ligjit për ZRRE ose të shtohet ndonjë nen tjetër që përcakton llojet e autorizimeve, bazuar në fushat e energjisë së ripërtërihem në të cilat lëshohet.

2.Duhet të qartësohet çështja e afatit dhe kohëzgjatjes së këtyre llojeve të autorizimit. Sipas nenit 17 të Rregulla - ZRRE/Nr. 03/2022 për procedurën e autorizimit për ndërtimin e projekteve të energjisë përcakton kohëzgjatjen e autorizimit për 24 muaj dhe mundësinë që ky lloji i autorizimit të vazhdohet edhe për 12 muaj, nëse vërtetohet që se rrethanat nuk kanë qenë në kontrollin e aplikuesit. Megjithatë në praktikë (psh rasti i vendimit: V 1211, 2.11.2019), ky lloji i autorizimit është lëshuar për 3 vite e 4 muaj. Duke parë që kohëzgjatja e këtyre llojeve të autorizimeve ka një rëndësi për palën, duhet të shikohet mundësia që kohëzgjatja e këtyre autorizimeve të zgjatet deri në pesë (5) vite, kurse minimumi i kohëzgjatjes të jetë për 3 vite. Një gjë e tillë mund të përcaktohet me rregull të nxjerrë nga ZRRE ose ndryshimin e rregullores, për të përcaktuar një afat më të gjatë të vlefshmërisë së autorizimeve, me qëllim që ndaj palëve të ketë një qasje më fleksibile dhe lehtësuese lidhur me këtë lloji të lejimit.

3. Lidhur me dokumentet respektive që pala duhet të dorëzojë, me rastin e aplikimit, disa prej tyre mund të verifikohen sipas parimit të ndihmës juridike në mes të organeve si dhe parimit të zhvillimit ex officio të procedurës apo përmes deklaratës nën betim. Referuar tabelës 1.5.

4.Përsa i përket taksës, ZRRE duhet të bëjë përpjekje që taksën fillestare, palëve të ja mundësojë që ta paguajnë, pasi që të përfundojë procedura dhe pasi të njëjtëve ti miratohet kërkesa. Kjo të të lehtësonte barrën administrative të palëve dhe do të zbatonte parimin e njohur nga LPPA, për zhvillimin e një procedure pa ngarkesa financiare për palën. Taksa e rishikimit të licencës, kur ky rishikim kërkohet nga ZRRE, sipas nenit 36.2, rekomandohet të hiqet.

5.Në kuadër të nenit 1 të Rregulla - ZRRE/Nr. 03/2022 për procedurën e autorizimit për ndërtimin e projekteve të energjisë, përcakton termin “Aplikant”, si vijon: “çdo person fizik apo juridik, i themeluar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar apo shoqëri aksionare, që dëshiron të ndërtojë një Projekt Energetik dhe që aplikon në ZRRE për Autorizim”. Për këtë arsye ZRRE duhet të përcaktoj në një nen të veçantë të rregullës për procedurën e autorizimit se kush ka të drejtë të aplikoj për këtë lloj lejimi dhe se a kanë të drejtë ta bëjnë personat fizik apo vetëm juridik.

6.Publikimi i njoftimit pas aplikacionit të mos bëhet nga pala në gazetën përkatëse. Një gjë e tillë të bëhet nga ZRRE. ZRRE, sipas parimit të zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare duhet të bëjë publikimin e njoftimit për aplikim të këtij lloji të autorizimit. Një qasje e tillë do të ndihmonte palën dhe do të zvogëlonte barrën administrative të saj. Për publikimin respektiv sipas nenit 13 të Rregulla - ZRRE/Nr. 03/2022 për procedurën e autorizimit për ndërtimin e projekteve të energjisë duhet të njoftohet pala.

7. Për të lehtësuar qasjen e palës në kuadër të këtij lloji të autorizimit, palës nuk duhet t’i refuzohet aplikacioni në rast se ai/ajo nuk e plotëson tërësisht dokumentacionin. Me këtë rast, ZRRE duhet të lejojë dhënien e sqarimeve deri në marrjen e vendimit përfundimtar për këtë lloji të autorizimit, bazuar në nenin 94 të LPPA. Për këtë duhet të ndryshohet neni 14 dhe nenet e tjera të Rregulla - ZRRE/Nr. 03/2022 për procedurën e autorizimit për ndërtimin e projekteve të energjisë, bazuar në nenin 94 të LPPA.

8.Duke pasur parasysh që nenin 17 i LSSL përcakton që lejet dhe licencat duhet të parashihen vetëm me ligj, atëherë kjo prek edhe materien e neneve 9 dhe 10 të Rregulla - ZRRE/Nr. 03/2022 për procedurën e autorizimit për ndërtimin e projekteve të energjisë, për shkak se si është thënë në rekomandimin e parë, llojet e këtyre autorizimeve duhet të përcaktohen vetëm me ligj.

2.AUTORIZIM PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE TË REJA NGA BIOMASA

1.Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës:

Neni 15 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084 përcakton detyrat e këtij rregullatori ndër të tjera: “1. Për përmbushjen e detyrave, Rregullatori ka autoritetin dhe përgjegjësitë në vijim: 1.15. **të lehtësojë qasje në rrjet për kapacitetet e reja prodhuese, në veçanti duke i larguar barrierat të cilat do të mund t’ua pamundësonin qasjen në treg palëve të reja nga burimet e ripërtëritshme të energjisë.** Në kuptim të nenin 15 par.1.15 të Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë ky lloji i licencës, i titulluar autorizim hyn ka të bëjë me fushëveprimin e rregullatorit të energjisë për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese. Baza konkrete ligjore për dhënien e këtij lejimi paraqitet në nenin 43 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084. Ky nen njeh dhënien e autorizimeve si lejime, për ndërtimin e kapaciteteve të reja. Neni 43.1 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084 përcakton: “**1. Ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese, sistemeve të reja për bartjen dhe shpërndarjen e gazit natyror, përfshirë interkonektorët, si dhe linjat direkte elektrike dhe gazsjellësit direkt për bartjen e gazit natyror do të bëhet në pajtim me procedurat e autorizimit sipas këtij ligji, përveç në rastet kur paragrafit 1 i nenit 44 të këtij ligji shprehimisht lejon përdorimin e procedurës së tenderimit**”. Megjithatë, vetëm pjesa e parë e nenit 43 flet për bazën ligjore andaj, është e udhës që baza për këtë lloj lejimi të jetë më specifike në ligj.

1.2 Veprimtaria për të cilën lëshohet leja/licenca:

Ky autorizim lëshohet për ndërtimin e kapaciteteve të reja nga biomasa. Veprimtaria për të cilën lëshohet kjo licencë mund të jetë veprimtari prodhuese, siç është rasti me vendimin V 1194/2019, 27.11.2019. Kjo licencë po ashtu lëshohet për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë konsumatorët dhe për ndërtimin e infrastrukturës energjetike.

1.3 Vlefshmëria kohore e lejes/licencës:

Sipas nenit 19 të Rregullës - ZRRE/Nr. 03/2022 si dhe sipas praktikës me vendimin V 1194/2019, kjo licencë lëshohet për 2 vite.

1.4.Taksa e nevojshme për pagesë

Pagese për shqyrtim të aplikacioneve për autorizim: A1. Autorizim për ndërtim të kapacitetit të ri 1000 Euro. Rishikim ndryshim dhe modifikim I autorizimit 500 Euro.

1.5 Dokumentet e nevojshme për aplikim:	Rekomandimet për zvogëlimin e barrës administrative, sipas LPA
1. Certifikatën e biznesit të lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Biznesit në Kosovë, duke përfshirë vendimin e bordit të kompanisë për përfaqësuesin e autorizuar për Aplikim	Duhet të vërtetohet nga ARBK, me kërkesë të ZRRE, sipas parimit të veprimit ex officio dhe ndihmës administrative. Pala vetëm duhet të konfirmoj që e posedon këtë dokument
2.Dëshmi mbi mundësitë financiare të Aplikuesit, dhe të kompanisë amë, duke përfshirë raportet financiare, siç kërkohen me ligjin për	Të dorëzohet nga pala

Kontabilitetin, Raportet Financiare dhe Auditimin, varësisht nga klasifikimi i ndërmarrjes;	
3. Dëshmi mbi kapacitetin financiar sipas Nenit 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 nënkuptoj se Aplikuesi posedon të paktën dhjetë (10%) përqind të vlerës së investimit. Kjo dëshmi duhet të mbështetet me deklaratë bankare të lëshuara jo më herët se pesë (5) ditë nga data e Aplikimit.	Të dorëzohet nga pala
4. Certifikatën e solvencës të biznesit të Aplikuesit, duke përfshirë edhe certifikatën e solvencës së biznesit të kompanisë amë, e lëshuar nga gjykata kompetente, ku dëshmohet se Aplikuesi apo kompania amë nuk është në falimentim;	ZRRE ta kërkojë këtë dokument nga KGJK, bazuar në parimin e ndihmës administrative dhe veprimit sipas detyrës zyrtare. Pala vetëm duhet të konfirmojë që e posedon këtë dokument.
5. Dëshmi nga organet tatimore se Aplikuesi, përfshirë kompaninë amë, nuk ka obligime tatimore;	ZRRE ta kërkojë këtë dokument nga Administrata Tatimore, bazuar në parimin e ndihmës administrative dhe veprimit sipas detyrës zyrtare. Pala vetëm duhet të konfirmojë që e posedon këtë dokument.
6. Dëshmi mbi të drejtat pronësore dhe ligjore të pronës ku do të ndërtohen Kapacitetet e Reja Gjeneruese;	Ky dokument të dorëzohet nga pala.
7. Studimi i fizibilitetit teknik dhe financiar, për projekt me kapacitet të instaluar mbi 1 MË;	Ky dokument duhet të dorëzohet nga pala.
8. Parakontrata ose Kontrata për Projektim, Prokurim dhe Ndërtim (EPC);	Ky dokument duhet të dorëzohet nga pala.
9. Plani i biznesit që përmban parametrat teknikë të projektit dhe planin financiar që përshkruan mënyrën e financimit, duke përfshirë koston totale të investimit dhe mënyrën e financimit; vlerësimin ekonomik dhe financiar të projektit duke përfshirë pasqyrat financiare; vlerësimin statik dhe dinamik të investimit (PBP, NPV, IRR dhe BP);	Ky dokument duhet të dorëzohet nga pala.
10. Akti komunal që konfirmon se Projekti Energjetik i propozuar është i lejuar sipas planeve zhvillimore ose hapësinore të Komunës;	Ky dokument duhet të dorëzohet nga pala.
11. Marrëveshja për kyçje me operatorin përkatës të sistemit;	Ky dokument duhet të dorëzohet nga pala.

12. Pëlqimin Mjedisor të lëshuar nga autoriteti përkatës, nëse kërkohet për projektin në fjalë;	ZRRE ta kërkoj këtë dokument nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), bazuar në parimin e ndihmës administrative dhe veprimit sipas detyrës zyrtare. Pala vetëm duhet të konfirmoj që e posedon këtë dokument.
13. Të drejtat Ujore nëse për projektin në fjalë kërkohet leja ujore në bazë të ligjit për Ujërat e Kosovës;	Ky dokument duhet të dorëzohet nga pala.
14. Lejen e ndërtimit të lëshuar nga Ministria përgjegjëse për ndërtim ose nga Komuna përkatëse, varësisht prej autoritetit që lëshon lejen sipas Ligjit të Ndërtimit.	Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) ose komuna, bazuar në parimin e ndihmës administrative dhe veprimit sipas detyrës zyrtare. Pala vetëm duhet të konfirmoj që e posedon këtë dokument.

2.Rekomandime:

1. Të bëhet ndryshimi i nenit 43 të Ligjit për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, në mënyrë që ky lloj i autorizimit të përcaktohet në mënyrë specifike.
2. Të zgjatet afati i vlefshmërisë, nga 3-5 vite.
3. Disa dokumente të nevojshme për aplikim për këtë autorizim të vërtetohen sipas parimit të ndihmës së organeve administrative dhe veprimit ex officio ose përmes deklaratës nën betim, e dorëzuar nga pala.
4. Taksa për autorizimin të paguhet në rast të miratimit të kërkesës dhe nxjerrjes së vendimit për miratim.
5. Të përcaktohet saktësisht nëse për këtë autorizim mund të aplikojnë personat fizik.
6. Publikimi i njoftimit sipas nenit 13 të rregullës - ZRRE/Nr. 03/2022, të behët nga ZRRE në ueb faqe.
7. Dorëzimi i sqarimeve nga pala të bëhet deri në momentin e marrjes së vendimit përfundimtar, brenda afatit maksimal të shqyrtimit 45 ditor, duke ndryshuar nenin 14.2 të rregullës - ZRRE/Nr. 03/2022.
8. Të ndryshohen neni 9 dhe 10 i Rregullës - ZRRE/Nr. 03/2022.

3.Arsyetimi i rekomandimeve

1.Në kuptim të nenit 43 të Ligjit për ZRRE, emërtimi i këtij lloji të autorizimit si Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja nga biomasa, nuk është i përcaktuar me ligj. Neni 43 i Ligjit për ZRRE, përcakton vetëm mundësinë e ndërtimit të kapaciteteve të reja, pa specifikuar llojet e energjisë së ripërtitshme, edhe pse të njëjtat përmenden në ligjet e veçanta. Megjithatë në Ligjin për ZRRE duhet të përcaktohet emërtimi i plotë i llojeve të autorizimeve që lëshon ZRRE, në bazë të ligjeve të veçanta që i zbaton ZRRE siç janë: Ligjin Nr. 05/L – 085 për Energjinë; Ligji Nr. 05/L – 085 për Energjinë Elektrike; Ligji Nr. 05/L-082 për Gazin Natyror; Ligjit Nr. 05/L -052 për Energjinë Termike. Për të pasur bazën konkrete ligjore, duhet të ndryshohet neni 43 i Ligjit për ZRRE ose të shtohet ndonjë nen tjetër që përcakton llojet e autorizimeve, bazuar në fushat e energjisë së ripërtërihem në të cilat lëshohet.

2.Duhet të qartësohet çështja e afatit dhe kohëzgjatjes së këtyre llojeve të autorizimit. Sipas nenit 17 të Rregulla - ZRRE/Nr. 03/2022 për procedurën e autorizimit për ndërtimin e projekteve të energjisë përcakton kohëzgjatjen e autorizimit për 24 muaj dhe mundësinë që ky lloji i autorizimit të vazhdohet edhe për 12 muaj, nëse vërtetohet që se rrethanat nuk kanë qenë në kontrollin e aplikuesit. Sipas praktikës dhe vendimeve të lëshuara, ky lloji i autorizimit lëshohet për 2 vite. Duke parë që kohëzgjatja e këtyre llojeve të autorizimeve ka një rëndësi për palën, duhet të shikohet mundësia që kohëzgjatja e këtyre autorizimeve të zgjatet deri në pesë (5) vite, kurse minimumi i kohëzgjatjes të jetë për 3 vite. Një gjë e tillë mund të përcaktohet me rregull të nxjerrë nga ZRRE ose ndryshimin e rregullores, për të përcaktuar një afat më të gjatë të vlefshmërisë së autorizimeve, me qëllim që ndaj palëve të ketë një qasje më fleksibile dhe lehtësuese lidhur me këtë lloji të lejitimit.

3.Lidhur me dokumentet respektive që pala duhet të dorëzojë, me rastin e aplikimit, disa prej tyre mund të verifikohen sipas parimit të ndihmës juridike në mes të organeve si dhe parimit të zhvillimit ex officio të procedurës apo përmes deklaratës nën betim. Ky rekomandim i adresuar në pikën 1.5.

4.Përsa i përket taksës, ZRRE duhet të bëjë përpjekje që taksën fillestare, palëve të ja mundësojë që ta paguajnë, pasi që të përfundojë procedura dhe pasi të njëjtëve ti miratohet kërkesa. Kjo të lehtësonte barrën administrative të palëve dhe do të zbatonte parimin e njohur nga LPPA, për zhvillimin e një procedure pa ngarkesa financiare për palën. Taksa e rishikimit të licencës, kur ky rishikim kërkohet nga ZRRE, sipas nenit 36.2, rekomandohet të hiqet.

5.Në kuadër të nenit 1 të Rregulla - ZRRE/Nr. 03/2022 për procedurën e autorizimit për ndërtimin e projekteve të energjisë, përcakton termin “*Aplikant*”, si vijon: “*çdo person fizik apo juridik, i themeluar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar apo shoqëri aksionare, që dëshiron të ndërtojë një Projekt Energjetik dhe që aplikon në ZRRE për Autorizim*”. Për këtë arsye ZRRE duhet të përcaktoj në një nen të veçantë të rregullës për procedurën e autorizimit se kush ka të drejtë të aplikoj për këtë lloj lejimi dhe se a kanë të drejtë ta bëjnë personat fizik apo vetëm juridik.

6.Publikimi i njoftimit pas aplikacionit të mos bëhet nga pala në gazetën përkatëse. Një gjë e tillë të bëhet nga ZRRE. ZRRE, sipas parimit të zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare duhet të bëjë publikimin e njoftimit për aplikim të këtij lloji të autorizimit. Një qasje e tillë do të ndihmonte palën dhe do të zvogëlonte barrën administrative të saj. Për publikimin respektiv sipas nenit 13 të Rregulla - ZRRE/Nr. 03/2022 për procedurën e autorizimit për ndërtimin e projekteve të energjisë duhet të njoftohet pala.

7. Për të lehtësuar qasjen e palës në kuadër të këtij lloji të autorizimit, palës nuk duhet ti refuzohet aplikacioni në rast se ai/ajo nuk e plotëson tërësisht dokumentacionin. Me këtë rast, ZRRE duhet të lejojë dhënien e sqarimeve deri në marrjen e vendimit përfundimtar për këtë lloji të autorizimit, bazuar në nenin 94 të LPPA. Për këtë duhet të ndryshohet neni 14 dhe nenet e tjera të Rregulla - ZRRE/Nr. 03/2022 për procedurën e autorizimit për ndërtimin e projekteve të energjisë, bazuar në nenin 94 të LPPA.

8.Duke pasur parasysh që nenin 17 i LSLL përcakton që lejet dhe licencat duhet të parashihen vetëm me ligj, atëherë kjo prek edhe materien e neneve 9 dhe 10 të Rregulla - ZRRE/Nr. 03/2022 për procedurën e autorizimit për ndërtimin e projekteve të energjisë, për shkak se si është thënë në rekomandimin e parë, llojet e këtyre autorizimeve duhet të përcaktohen vetëm me ligj.

3.LICENCIM I AKTIVITETIT TË FURNIZIMIT PUBLIK ME ENERGJI TERMIKE

1.Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës:

Baza ligjore e kësaj licence është në nenin 28.10 të Ligjit për ZRRE, i cili përcakton që për licence kanë nevojë aktivitetet për furnizimin me energji elektrike, energji termike apo gaz natyror, duke përfshirë transitin, importimin ose eksportimin e energjisë elektrike ose gazit natyror. Gjithashtu, në kuptim të kësaj licence, neni 18 i Ligjit për Energjinë Termike Nr. 05/L -052, njeh furnizimin publik si kategori. Neni 3 par. 1.9 përcakton “Furnizuesi publik – ndërmarrja e energjisë termike e licencuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji për të kryer veprimtarinë e furnizimit publik”. Gjithashtu, ky ligj e definon edhe kuptimin e licencës si një dokument që lëshohet nga ZRRE për të ushtruar aktivitete në sektorin e energjisë

1.2 Veprimtaria për të cilën lëshohet leja/licenca:

Kjo licence lëshohet për furnizim publik me energji termike nga ana e ndërmarrjes së licencuar nga ZRRE, bazuar në ligjin për ZRRE si dhe ligjin në fuqi për Energji Termike. Qëllimi i kësaj licence është vetëm veprimtaria e furnizimit nga ndërmarrje publike, që janë të licencuara për kryerjen e këtij aktiviteti.

1.3 Vlefshmëria kohore e lejes/licencës:

Sipas nenit 32 paragrafi 2.2 afati maksimal i kësaj licence e cila lëshohet nga ZRRE është 25 vjet.

1.4. Pagesa e taksës

2,000 € (tetëmijë euro). Pagese fillestare; dhe 500 € (pesëqind euro) - Pagese për rishikim-modifikim/ndryshim apo vazhdim, dhe transfer licence.

1.5 Dokumentet e nevojshme për aplikim:	Rekomandimet për zvogëlimin e barrës, sipas LPA
1. Kopjen e Certifikatës së Regjistrimit, të lëshuar nga agjencia për regjistrimin e bizneseve në Kosovë, ku aplikuesit i kërkohet me ligj regjistrimi i biznesit në Kosovë;	Duhet të vërtetohet nga ARBK, me kërkesë të ZRRE, sipas parimit të veprimit ex officio dhe ndihmës administrative. Pala vetëm duhet të konfirmoj që e posedon këtë dokument.
2. Statutin e ndërmarrjes apo marrëveshjen e krijimit të shoqërisë;	Dokumenti të dorëzohet nga pala.
3. Planin afarist të aplikuesit, lidhur me aktivitetet energjetike që do të mbulohen nga licenca, që mbulon së paku tre (3) vite të ardhshme;	Dokumenti të dorëzohet nga pala.
4. Pasqyrat financiare vjetore të aplikuesit për tre (3) vitet e fundit. Këto pasqyra financiare duhet të jenë të audituara nga auditorë të licencuar dhe të pavarur financiarë. Aplikuesi do të dorëzoj raportin e auditorëve veçmas nga gjendja	Dokumenti të dorëzohet nga pala.

financiare, ndërsa ndërmarrja e sapokrijuar të dorëzoj deklaratën financiare dhe informacione në lidhje me përvojën e partnerëve ose aksionarëve të tij, nëse ka, në përmbushjen e aktiviteteve të ngjashme për energji;	
5. Dëshmi nga një institucion financiar ose institucione që konfirmojnë disponueshmërinë e fondeve për aktivitetin e energjisë (p.sh garanci Bankare për aplikuesin ose kompaninë amë, ose dëshmi të ngjashme të disponueshmërisë së fondeve të mjaftueshme për financimin e aktivitetit për të cilin kërkohet licencë);	Dokumenti të dorëzohet nga pala.
6. Certifikatën nga organi kompetent që aplikuesi i përmbush detyrimet ligjore lidhur me pagimin e taksave (Vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës);	ZRRE ta kërkoj këtë dokument nga Administrata Tatimore, bazuar në parimin e ndihmës administrative dhe veprimit sipas detyrës zyrtare. Pala vetëm duhet të konfirmoj që e posedon këtë dokument.
9. Biografite (CV-të) e stafit menaxhues dhe personelit tjetër të lartë të aplikuesit, së bashku me kualifikimet e tyre;	Pala vetëm duhet të deklaroj këtë përmes deklaratës nën betim.
10. Informacione në lidhje me strukturën organizative (menaxhmentin dhe personelin profesional) të aplikuesit;	Pala vetëm duhet të deklaroj këtë përmes deklaratës nën betim, pasi këto janë në statutin e bartësit. Ky dokument duhet të eliminohet.
11. Dëshmi për pagesën e taksës së aplikueshme për licencim (në pajtim me Nenin 4 paragrafin 5 të kësaj Rregulle);	Dokumenti të dorëzohet nga pala.
12. Dëshmi mbi publikimin e Njoftimit në dy (2) gazeta ditore me qarkullim të gjerë në Kosovë (në pajtim me Nenin 6 të kësaj rregulle).	Këtë shpallje duhet ta bëjë organi dhe jo pala. Kjo kërkon ndryshimin e rregulloreve.

2.Rekomandime:

1. Të përcaktohet nëse për këtë licencë aplikon personi fizik apo vetëm ai juridik (ndërmarrje), duke definuar termin aplikues;
2. Të shmangen disa dokumente dhe të njëjtat të vërtetohen sipas parimit të zhvillimit të procedurës, sipas detyrës zyrtare apo parimit të ndihmës juridike të organeve ose përmes deklaratës nën betim;
3. Ri aplikimi për licencë të bëhet me veprim të ZRRE, sipas detyrës zyrtare;
4. Publikimi i njoftimit për aplikim të bëhet nga ana e ZRRE;
5. Palës ti jepet mundësia që të ofrojë dëshmi shtesë, deri në marrjen e vendimit përfundimtar për licencën;
6. Taksa e aplikimit të paguhet me rastin e miratimit të aplikacionit dhe të hiqet taksa e rishikimit të licencës kur këtë e kërkon ZRRE.

3.Arsyetime i rekomandimeve

1. Rregulla ZRRE/Nr. 07/2017 për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë, në nenin 2 përcakton termin aplikues si në vijim: “personi fizik apo juridik që aplikon për licencim të aktivitetit të energjisë, në pajtim me kushtet e kësaj Rregulle dhe kur licenca i lëshohet një shoqërie tregtare të sapokrijuar, do të përfshijë kompaninë mëmë (nëse ka) ose kompanitë që zotërojnë dhe kontrollojnë shoqërinë e re tregtare”. Megjithatë përmes kësaj rregullore të brendshme, për të bërë më të lehtë për palët çështjen e aplikimit për qytetarët, duhet të përcaktohet se për cilat licenca mund të aplikohet nga personat fizik dhe për cilat personat juridik. Kjo mund të bëhet përmes ndryshimit dhe plotësimit të aktit nënligjor nga ZRRE.

2. Me qëllim të lehtësimit dhe zvogëlimit të barrë administrative për palën, lidhur me dokumentet respektive që pala duhet të dorëzojë, me rastin e aplikimit, disa prej tyre mund të verifikohen sipas parimit të ndihmës juridike në mes të organeve si dhe parimit të zhvillimit ex officio të procedurës apo përmes deklaratës nën betim. Referuar tabelës 1.5.

3. Me rastin e vazhdimit të licencës, ZRRE të veprojë sipas parimit të detyrës zyrtare dhe të njoftojë palën si dhe të kërkojë nga pala ofrimin e informacioneve, sipas nevojës me qëllim të vazhdimit të licencës. Kjo mund të bëhet duke ndryshuar rregullat e përcaktuara me akt nënligjor, që rregullojnë procedurën e shqyrtimit të licencave nga ZRRE.

4. Publikimi i njoftimit pas aplikacionit të mos bëhet nga pala në gazetën përkatëse. Një gjë e tillë të bëhet nga ZRRE. ZRRE, sipas parimit të zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare duhet të bëjë publikimin e njoftimit për aplikim të këtij lloji të autorizimit. Një qasje e tillë do të ndihmonte palën dhe do të zvogëlonte barrën administrative të saj. Për të mundësuar një gjë e tillë duhet të ndryshohet neni 6 të Rregulla ZRRE/Nr. 07/2017 për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë, për të cilin duhet të njoftohet pala.

5. Për të lehtësuar qasjen e palës në kuadër të kësaj lloji të licencës, palës nuk duhet ti refuzohet aplikacioni në rast se ai/ajo nuk e plotëson tërësisht dokumentacionin. Me këtë rast, ZRRE duhet të lejojë dhënien e sqarimeve deri në marrjen e vendimit përfundimtar për këtë lloji të licencës, bazuar në nenin 94 të LPPA. Për këtë duhet të ndryshohen nenet përkatëse të Rregullës ZRRE/Nr. 07/2017 për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë, me qëllim që palës ti mundësohet që të dorëzojë dëshmi dhe sqarime, deri në përfundimin e afatit për vendosje.

6. Me qëllim të lehtësimit të barrës administrative për palët, duhet që taksa e aplikimit të paguhet në fund, me rastin e miratimit të vendimit. Kurse taksa e modifikimit të licencës me kërkesë të ZRRE të hiqet. Për këtë duhet të ndryshohen rregulloret e brendshme që rregullojnë procedurën e shqyrtimit të licencave dhe rregullorja respektive për taksat.

4.LICENCË E AKTIVITETIT PËR BASHKËPRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE NGROHJES

1.Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës:

Baza ligjore e licencave përcaktohet në Ligjin për ZRRE, respektivisht nenin 28 paragrafi 2. Megjithatë, në kuptim të aktivitetit specifik sipas emërimit të kësaj licence, në paragrafin 2 nuk përcaktohet “**bashkëprodhim i energjisë elektrike dhe ngrohjes**”. I vetmi bashkëprodhim që përcaktohet në këtë nen, për aktivitetet që nevojitet licencë është bashkëprodhimi i **energjisë elektrike dhe termike**. Po ashtu, i vetmi nen që i referohet bashkëprodhimit, duke lidhur aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike dhe ngrohjes

është neni 8 i Ligjit Nr. 05/L – 085 për Energjinë Elektrike, megjithatë neni respektiv nuk i referohet dhënies së licencës. Andaj kjo licencë nuk ka bazë konkrete ligjore.

1.2 Veprimtaria për të cilën lëshohet leja/licenca:

Kjo licencë, sipas emërimit lëshohet për aktivitetet e bashkëprodhimit të energjisë elektrike dhe ngrohjes. Qëllimi i kësaj licence është që të përfshijë të dyja aktivitetet, prodhimin e energjisë dhe ngrohjes si një aktivitet i përbashkët.

1.3 Vlefshmëria kohore e lejes/licencës:

Sipas nenit 32 paragrafi 2.1, afati maksimal për aktivitetet e bashkëprodhimit të energjisë elektrike.

1.4. Pagesa e taksës

1,000.00 € - Pagesë fillestare: (njëmijë euro). 500 € (pesëqind euro) - Pagesë për rishikim-modifikim/ndryshim apo vazhdim, dhe transfer licence.

1.5 Dokumentet e nevojshme për aplikim:

Sipas RQLL Dokumentacioni ka mbetur të caktohet me akt nënligjor të veçantë. Kurse Rregulla ZRRE/Nr. 07/2017 PËR LICENCIMIN E AKTIVITETEVE TË ENERGIJËSË NË KOSOVË, neni 8, i përcakton dokumentet e përgjithëshme.

2.Rekomandime:

1. Licenca të përcaktohet me ligj;
2. Të përcaktohet nëse për këtë licencë aplikon personi fizik apo vetëm ai juridik (ndërmarrje), duke definuar termin aplikues;
3. Ri aplikimi për licencë të bëhet sipas veprimit sipas detyrës zyrtare nga ZRRE;
4. Publikimi i njoftimit për aplikim të bëhet nga ana e ZRRE;
5. Palës ti jepet mundësia që të ofrojë dëshmi shtesë, deri në marrjen e vendimit përfundimtar për licencën;
6. Taksa e aplikimit të paguhet me rastin e miratimit të aplikacionit dhe të hiqet taksa e rishikimit të licencës kur këtë e kërkon ZRRE.

2.Arsyetimi i rekomandimeve

1.Licencës dhe lëshimit të saj i mungon baza ligjore konkrete, sipas sqarimeve tek baza ligjore e kësaj licence. Andaj, në duhet që në nenin përkatës të Ligjit për ZRRE të përcaktohet edhe veprimtaria e bashkëprodhimit të energjisë elektrike dhe ngrohjes si aktivitet i përbashkët. Për të arritur këtë minimalisht duhet të ndryshohet neni 28 i Ligjit për ZRRE, konform neni 17 të LSLL që përcakton se licenca duhet të përcaktohet me ligj.

2.Rregulla ZRRE/Nr. 07/2017 për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë, në nenin 2 përcakton termin aplikues si në vijim: “personi fizik apo juridik që aplikon për licencim të aktivitetit të energjisë, në pajtim me kushtet e kësaj Rregulle dhe kur licenca i lëshohet një shoqërie tregtare të sapokrijuar, do të përfshijë kompaninë mëmë (nëse ka) ose kompanitë që zotërojnë dhe kontrollojnë shoqërinë e re tregtare”. Megjithatë përmes kësaj rregullore të brendshme, për të bërë më të lehtë për palët çështjen e aplikimit për

qytetarët, duhet të përcaktohet se për cilat licenca mund të aplikohet nga personat fizik dhe për cilat personat juridik. Kjo mund të bëhet përmes ndryshimit dhe plotësimit të aktit nënligjor.

3. Me rastin e vazhimit të licencës, ZRRE të veprojë sipas parimit të detyrës zyrtare dhe të njoftojë palën si dhe të kërkojë nga pala ofrimin e informacioneve, sipas nevojës me qëllim të vazhimit të licencës. Kjo mund të bëhet duke ndryshuar rregullat e përcaktuara me akt nënligjor, që rregullojnë procedurën e shqyrtimit të licencave nga ZRRE.

4. Publikimi i njoftimit pas aplikacionit të mos bëhet nga pala në gazetën përkatëse. Një gjë e tillë të bëhet nga ZRRE. ZRRE, sipas parimit të zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare duhet të bëjë publikimin e njoftimit për aplikim të këtij lloji të autorizimit. Një qasje e tillë do të ndihmonte palën dhe do të zvogëlonte barrën administrative të saj. Për të mundur një gjë e tillë duhet të ndryshohet neni 6 të Rregulla ZRRE/Nr. 07/2017 për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë, për të cilin duhet të njoftohet pala.

5. Për të lehtësuar qasjen e palës në kuadër të kësaj lloji të licencës, palës nuk duhet ti refuzohet aplikacioni në rast se ai/ajo nuk e plotëson tërësisht dokumentacionin. Me këtë rast, ZRRE duhet të lejojë dhënien e sqarimeve deri në marrjen e vendimit përfundimtar për këtë lloji të licencës, bazuar në nenin 94 të LPPA. Për këtë duhet të ndryshohen nenet përkatëse të Rregullës ZRRE/Nr. 07/2017 për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë, me qëllim që palës t'i mundësohet që të dorëzojë dëshmi dhe sqarime, deri në përfundimin e afatit për vendosje.

6. Me qëllim të lehtësimit të barrës administrative për palët, duhet që taksa e aplikimit të paguhet në fund, me rastin e miratimit të vendimit. Kurse taksa e modifikimit të licencës me kërkesë të ZRRE të hiqet. Për këtë duhet të ndryshohen rregulloret e brendshme që rregullojnë procedurën e shqyrtimit të licencave dhe rregullorja respektive për taksat.

5. LICENCË E AKTIVITETIT, SHPËRNDARJA E NGROHJES APO GAZIT NATYROR

1. Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës:

Baza ligjore e kësaj licence përcaktohet në nenin 28 paragrafi 2.8, që përfshin shpërndarjen energjisë termike dhe të gazit natyror. Si e tillë baza ligjore për licencim të këtij aktiviteti është e qartë dhe konkrete në ligjin për ZRRE.

1.2 Veprimtaria për të cilën lëshohet leja/licenca:

Kjo licencë ka për qëllim shpërndarjen e ngrohjes dhe gazit natyror dhe është e lidhur për aktivitetin e shpërndarjes.

1.3 Vlefshmëria kohore e lejes/licencës:

Varësisht nga jetëgjatësia e aseteve të përdorura për kryerjen e aktiviteteve relevante me kohëzgjatje që nuk mund të tejkalojë periudhën dyzet (40) vjeçare.

1.4. Pagesa e taksës

1,000.00 € - Pagesë fillestare: (njëmijë euro). 500 € (pesëqind euro) - Pagesë për rishikim-modifikim/ndryshim apo vazhdim, dhe transfer licence.

1.5 Dokumentet e nevojshme për aplikim:	Rekomandimet për zvogëlimin e barrës, sipas LPA
1. Kopjen e Certifikatës së Regjistrimit, të lëshuar nga agjencia për regjistrimin e bizneseve në Kosovë, ku aplikuesit i kërkohet me ligj regjistrimi i biznesit në Kosovë;	Duhet të vërtetohet nga ARBK, me kërkesë të ZRRE, sipas parimit të veprimit ex officio dhe ndihmës administrative. Pala vetëm duhet të konfirmoj që e posedon këtë dokument.
2. Statutin e ndërmarrjes apo marrëveshjen e krijimit të shoqërisë;	Dokumenti të dorëzohet nga pala.
3. Planin afarist të aplikuesit, lidhur me aktivitetet energjetike që do të mbulohen nga licenca, që mbulon së paku tre (3) vite të ardhshme;	Dokumenti të dorëzohet nga pala.
4. Pasqyrat financiare vjetore të aplikuesit për tre (3) vitet e fundit. Këto pasqyra financiare duhet të jenë të audituara nga auditorë të licencuar dhe të pavarur financiarë. Aplikuesi do të dorëzoj raportin e auditorëve veçmas nga gjendja financiare, ndërsa ndërmarrja e sapokrijuar të dorëzoj deklaratën financiare dhe informacione në lidhje me përvojën e partnerëve ose aksionarëve të tij, nëse ka, në përmbushjen e aktiviteteve të ngjashme për energji;	Dokumenti të dorëzohet nga pala.
5. Dëshmi nga një institucion financiar ose institucione që konfirmojnë disponueshmërinë e fondeve për aktivitetin e energjisë (p.sh garanci Bankare për aplikuesin ose kompaninë amë, ose dëshmi të ngjashme të disponueshmërisë së fondeve të mjaftueshme për financimin e aktivitetit për të cilin kërkohet licencë);	Dokumenti të dorëzohet nga pala.
6. Certifikatën nga organi kompetent që aplikuesi i përmbush detyrimet ligjore lidhur me pagimin e taksave (Vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës);	ZRRE ta kërkoj këtë dokument nga Administrata Tatimore, bazuar në parimin e ndihmës administrative dhe veprimit sipas detyrës zyrtare. Pala vetëm duhet të konfirmoj që e posedon këtë dokument.
9. Biografite (CV-të) e stafit menaxhues dhe personelit tjetër të lartë të aplikuesit, së bashku me kualifikimet e tyre;	Pala vetëm duhet të deklaroj këtë përmes deklaratës nën betim.

10. Informacione në lidhje me strukturën organizative (menaxhmentin dhe personelin profesional) të aplikuesit;	Pala vetëm duhet të deklaroj këtë përmes deklaratës nën betim, pasi këto janë në statutin e bartësit. Ky dokument duhet të eliminohet.
11. Dëshmi për pagesën e taksës së aplikueshme për licencim (në pajtim me Nenin 4 paragrafin 5 të kësaj Rregulle);	Dokumenti të dorëzohet nga pala.
12. Dëshmi mbi publikimin e Njoftimit në dy (2) gazeta ditore me qarkullim të gjerë në Kosovë (në pajtim me Nenin 6 të kësaj rregulle).	Këtë shpallje duhet ta bëjë organi dhe jo pala. Kjo kërkon ndryshimin e rregulloreve.

Rregulla ZRRE/Nr. 07/2017 neni 12 përcakton Dokumentet specifike të operatorit të shpërndarjes:

1. Një përshkrim të karakteristikave përkatëse të sistemit ose sistemeve të shpërndarjes, bashkë me karakteristikat e tyre teknike dhe territorin për shpërndarjen e energjisë elektrike, energjisë termike dhe gazit natyror.
2. Dëshmi lidhur me pronësinë ose të drejtën ligjore për përdorimin e elementeve të sistemit;
3. Planin zhvillimor të sistemit, siç përcaktohet në Nenin 10 të Ligjit për Energjinë, Nenin 15, paragrafi 3, nënparagrafi 3.2 të Ligjit për Energjinë Termike dhe Nenin 22 të Ligjit për Gazin Natyror, sipas rastit;
4. Dëshmi lidhur me numrin e pritur dhe strukturën e konsumatorëve të kyçur dhe atyre potencial;
5. Dëshmi për aftësinë dhe disponueshmërinë e sistemit të harduerit dhe softuerit të nevojshëm, bashkë me të gjitha burimet e nevojshme financiare, njerëzore dhe teknike që aplikuesi të mund t'i kryej detyrat e përcaktuara me Nenin 16 të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe Nenin 18 të Ligjit për Gazin Natyror, sipas rastit.
6. Treguesit për matjen e cilësisë së furnizimit me energji (kohëzgjatjen, frekuencat, numrin e ndërprerjeve, ndërprerjet e shprehura në minuta për konsumator etj.) dhe shërbimet në operimin e sistemit (informatat e përgjithshme, marrëveshjet për leximin e njehsorëve, kohën e kyçjes, dështimet, rivendosjen e sistemit energjetik pas dështimeve etj.);
7. Specifikimet dhe karakteristikat teknike të pajisjeve matëse të sistemit të shpërndarjes; dhe
8. Marrëveshjen për kyçje në sistemin e transmetimit.

2.Rekomandime:

1. Të përcaktohet nëse për këtë licencë aplikon personi fizik apo vetëm ai juridik (ndërmarrje), duke definuar termin aplikues;
2. Të shmangen disa dokumente dhe të njëjtat të vërtetohen sipas parimit të zhvillimit të procedurës, sipas detyrës zyrtare apo parimit të ndihmës juridike të organeve ose përmes deklaratës nën betim;
3. Ri aplikimi për licencë të bëhet sipas veprimit sipas detyrës zyrtare nga ZRRE;
4. Publikimi i njoftimit për aplikim të bëhet nga ana e ZRRE;
5. Palës ti jepet mundësia që të ofrojë dëshmi shtesë, deri në marrjen e vendimit përfundimtar për licencën;
6. Taksa e aplikimit të paguhet me rastin e miratimit të aplikacionit dhe të hiqet taksa e rishikimit të licencës kur këtë e kërkon ZRRE.

3.Arsyetimi i rekomandimeve

1. Rregulla ZRRE/Nr. 07/2017 për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë, në nenin 2 përcakton termin aplikues si në vijim: “personi fizik apo juridik që aplikon për licencim të aktivitetit të energjisë, në pajtim me kushtet e kësaj Rregulle dhe kur licenca i lëshohet një shoqërie tregtare të sapokrijuar, do të përfshijë kompaninë mëmë (nëse ka) ose kompanitë që zotërojnë dhe kontrollojnë shoqërinë e re tregtare”. Megjithatë përmes kësaj rregullore të brendshme, për të bërë më të lehtë për palët çështjen e aplikimit për qytetarët, duhet të përcaktohet se për cilat licenca mund të aplikohet nga personat fizik dhe për cilat personat juridik. Kjo mund të bëhet përmes ndryshimit dhe plotësimit të aktit nënligjor.

2. Me qëllim të lehtësimit dhe zvogëlimit të barrë administrative për palën, lidhur me dokumentet respektive që pala duhet të dorëzojë, me rastin e aplikimit, disa prej tyre mund të verifikohen sipas parimit të ndihmës juridike në mes të organeve si dhe parimit të zhvillimit ex officio. Për këtë duhet ti referohemi tabelës 1.5. Dëshmitë e tjera specifike duhet të dorëzohen nga pala.

3. Me rastin e vazhdimit të licencës, ZRRE të veprojë sipas parimit të detyrës zyrtare dhe të njoftojë palën si dhe të kërkojë nga pala ofrimin e informacioneve, sipas nevojës me qëllim të vazhdimit të licencës. Kjo mund të bëhet duke ndryshuar rregullat e përcaktuara me akt nënligjor, që rregullojnë procedurën e shqyrtimit të licencave nga ZRRE.

4. Publikimi i njoftimit pas aplikacionit të mos bëhet nga pala në gazetën përkatëse. Një gjë e tillë të bëhet nga ZRRE. ZRRE, sipas parimit të zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare duhet të bëjë publikimin e njoftimit për aplikim të këtij lloji të autorizimit. Një qasje e tillë do të ndihmonte palën dhe do të zvogëlonte barrën administrative të saj. Për të mundësuar një gjë të tillë duhet të ndryshohet neni 6 të Rregulla ZRRE/Nr. 07/2017 për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë, për të cilin duhet të njoftohet pala.

5. Për të lehtësuar qasjen e palës në kuadër të kësaj lloji të licencës, palës nuk duhet ti refuzohet aplikacioni në rast se ai/ajo nuk e plotëson tërësisht dokumentacionin. Me këtë rast, ZRRE duhet të lejojë dhënien e sqarimeve deri në marrjen e vendimit përfundimtar për këtë lloji të licencës, bazuar në nenin 94 të LPPA. Për këtë duhet të ndryshohen nenet përkatëse të Rregullës ZRRE/Nr. 07/2017 për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë, me qëllim që palës t'i mundësohet që të dorëzojë dëshmi dhe sqarime, deri në përfundimin e afatit për vendosje.

6. Me qëllim të lehtësimit të barrës administrative për palët, duhet që taksa e aplikimit të paguhet në fund, me rastin e miratimit të vendimit. Kurse taksa e modifikimit të licencës me kërkesë të ZRRE të hiqet. Për këtë duhet të ndryshohen rregulloret e brendshme që rregullojnë procedurën e shqyrtimit të licencave dhe rregullorja respektive për taksat.

6.AUTORIZIM PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE TË REJA NGA ENERGJIA SOLARE

1 Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës:

Neni 15 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084 përcakton detyrat e këtij rregullatori ndër të tjera: “1. Për përmbushjen e detyrave, Rregullatori ka autoritetin dhe përgjegjësitë në vijim: 1.15. ***të lehtësojë qasje në rrjet për kapacitetet e reja prodhuese, në veçanti duke i larguar barrierat të cilat do të mund t’ua pamundësonin qasjen në treg palëve të reja nga burimet e ripërtërishme të energjisë.*** Në kuptim të nenin 15 par.1.15 të Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë ky lloji i licencës, i titulluar autorizim ka të bëjë me fushëveprimin e rregullatorit të energjisë për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese. Baza konkrete ligjore për dhënien e këtij lejimi paraqitet në nenin 43 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084. Ky nen njeh dhënien e autorizimeve si lejime, për ndërtimin e kapaciteteve të

reja. Neni 43.1 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084 përcakton: “**1. Ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese, sistemeve të reja për bartjen dhe shpërndarjen e gazit natyror, përfshirë interkonektorët, si dhe linjat direkte elektrike dhe gazsjellësit direkt për bartjen e gazit natyror do të bëhet në pajtim me procedurat e autorizimit sipas këtij ligji, përveç në rastet kur paragrafit 1 i nenit 44 të këtij ligji shprehimisht lejon përdorimin e procedurës së tenderimit**”. Megjithatë, vetëm pjesa e parë e nenit 43 flet për bazën ligjore andaj, është e udhës që baza për këtë lloj lejimi të jetë më specifike ose ky lloji i autorizimit/lejimit të përcaktohet me ligj. Baza e këtij autorizimi është vetëm në akt nënligjor dhe sipas rregullës - ZRRE/Nr. 03/2022, autorizimin nënkupton ndërtimin e kapaciteteve të reja nga biomasa.

1.2 Veprimtaria për të cilën lëshohet leja/licenca:

Ky autorizim lëshohet për ndërtimin e kapaciteteve të reja nga energjia solare. Në praktikë ZRRE ka lëshuar autorizime të tilla, si psh: vendimi nr.906/2017, datë 31.03.2023 ose vendimi nr.1639/2022, 29.12.2022.

1.3 Vlefshmëria kohore e lejes/licencës:

Sipas nenit 19 të Rregullës - ZRRE/Nr. 03/2022 si dhe sipas praktikës me vendimin V 1194/2019, kjo licencë lëshohet për 2 vite.

1.4.Taksa e nevojshme për pagesë

Autorizim për ndërtim të kapacitetit të ri 1000 Euro. Rishikim ndryshim dhe modifikim i autorizimit 500 Euro.

1.5 Dokumentet e nevojshme për aplikim:	Rekomandimet për zvogëlimin e barrës, sipas LPA
1. Certifikatën e biznesit të lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Biznesit në Kosovë, duke përfshirë vendimin e bordit të kompanisë për përfaqësuesin e autorizuar për Aplikim	Duhet të vërtetohet nga ARBK, me kërkesë të ZRRE, sipas parimit të veprimit ex officio dhe ndihmës administrative. Pala vetëm duhet të konfirmoj që e posedon këtë dokument.
2.Dëshmi mbi mundësitë financiare të Aplikuesit, dhe të kompanisë amë, duke përfshirë raportet financiare, siç kërkohen me ligjin për Kontabilitetin, Raportet Financiare dhe Auditimin, varësisht nga klasifikimi i ndërmarrjes;	Të dorëzohet nga pala
3. Dëshmi mbi kapacitetin financiar sipas Nenit 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 nënkuptoj se Aplikuesi posedon të paktën dhjetë (10%) përqind të vlerës së investimit. Kjo dëshmi duhet të mbështetet me deklaratat bankare të lëshuara jo më herët se pesë (5) ditë nga data e Aplikimit.	Të dorëzohet nga pala
4. Certifikatën e solvencës të biznesit të Aplikuesit, duke përfshirë edhe certifikatën e solvencës së biznesit të kompanisë amë, e lëshuar	ZRRE ta kërkojë këtë dokument nga KGJK, bazuar në parimin e ndihmës administrative dhe veprimit

nga gjykata kompetente, ku dëshmohet se Aplikuesi apo kompania amë nuk është në falimentim;	sipas detyrës zyrtare. Pala vetëm duhet të konfirmoj që e posedon këtë dokument.
5. Dëshmi nga organet tatimore se Aplikuesi, përfshirë kompaninë amë, nuk ka obligime tatimore;	ZRRE ta kërkoj këtë dokument nga Administrata Tatimore, bazuar në parimin e ndihmës administrative dhe veprimit sipas detyrës zyrtare. Pala vetëm duhet të konfirmoj që e posedon këtë dokument.
6. Dëshmi mbi të drejtat pronësore dhe ligjore të pronës ku do të ndërtohen Kapacitetet e Reja Gjeneruese;	Ky dokument të dorëzohet nga pala.
7. Studimi i fizibilitetit teknik dhe financiar, për projekt me kapacitet të instaluar mbi 1 MË;	Ky dokument duhet të dorëzohet nga pala.
8. Para kontrata ose Kontrata për Projektim, Prokurim dhe Ndërtim (EPC);	Ky dokument duhet të dorëzohet nga pala.
9. Plani i biznesit që përmban parametrat teknikë të projektit dhe planin financiar që përshkruan mënyrën e financimit, duke përfshirë koston totale të investimit dhe mënyrën e financimit; vlerësimin ekonomik dhe financiar të projektit duke përfshirë pasqyrat financiare; vlerësimin statik dhe dinamik të investimit (PBP, NPV, IRR dhe BP);	Ky dokument duhet të dorëzohet nga pala.
10. Akti komunal që konfirmon se Projekti Energjetik i propozuar është i lejuar sipas planeve zhvillimore ose hapësinore të Komunës;	Ky dokument duhet të dorëzohet nga pala.
11. Marrëveshja për kyçje me operatorin përkatës të sistemit;	Ky dokument duhet të dorëzohet nga pala.
12. Pëlqimin Mjedisor të lëshuar nga autoriteti përkatës, nëse kërkohet për projektin në fjalë;	ZRRE ta kërkoj këtë dokument nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), bazuar në parimin e ndihmës administrative dhe veprimit sipas detyrës zyrtare. Pala vetëm duhet të konfirmoj që e posedon këtë dokument.
13. Të drejtat Ujore nëse për projektin në fjalë kërkohet leja ujore në bazë të ligjit për Ujërat e Kosovës;	Ky dokument duhet të dorëzohet nga pala.
14. Lejen e ndërtimit të lëshuar nga Ministria përgjegjëse për ndërtim ose nga Komuna	Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) ose komuna, bazuar në parimin e ndihmës administrative dhe veprimit

përkatëse, varësisht prej autoritetit që lëshon lejen sipas Ligjit të Ndërtimit.	sipas detyrës zyrtare. Pala vetëm duhet të konfirmoj që e posedon këtë dokument.
--	--

2.Rekomandime:

1. Të bëhet ndryshimi i nenit 43 të Ligjit për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, në mënyrë që ky lloj i autorizimit të përcaktohet në mënyrë specifike me ligj.
2. Të zgjatet afati i vlefshmërisë, nga 3-5 vite.
3. Disa dokumente të nevojshme për aplikim për këtë autorizim të vërtetohen sipas parimit të ndihmës së organeve administrative dhe veprimit ex officio ose përmes deklaratës nën betim, e dorëzuar nga pala.
4. Taksa për autorizimin të paguhet në rast të miratimit të kërkesës dhe nxjerrjes së vendimit për miratim.
5. Të përcaktohet saktësisht nëse për këtë autorizim mund të aplikojnë personat fizik.
6. Publikimi i njoftimit sipas nenit 13 të rregullës - ZRRE/Nr. 03/2022, të behët nga ZRRE në ueb faqe.
7. Dorëzimi i sqarimeve nga pala të bëhet deri në momentin e marrjes së vendimit përfundimtar, brenda afatit maksimal të shqyrtimit 90 ditor, duke ndryshuar nenin 14.2 të rregullës - ZRRE/Nr. 03/2022.
8. Të ndryshohen nenin 9 dhe 10 i Rregullës - ZRRE/Nr. 03/2022.

3.Arsyetimi i rekomandimeve

1.Në kuptim të nenit 43 të Ligjit për ZRRE, emërtimi i këtij lloji të autorizimit si Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja nga era, nuk është i përcaktuar me ligj. Neni 43 i Ligjit për ZRRE, përcakton vetëm mundësinë e ndërtimit të kapaciteteve të reja, pa specifikuar llojet e energjisë së ripërtitshme, edhe pse të njëjtat përmenden në ligjet e veçanta. Megjithatë në Ligjin për ZRRE duhet të përcaktohet emërtimi i plotë i llojeve të autorizimeve që lëshon ZRRE, në bazë të ligjeve të veçanta që i zbaton ZRRE siç janë: Ligjin Nr. 05/L – 085 për Energjinë; Ligji Nr. 05/L – 085 për Energjinë Elektrike; Ligji Nr. 05/L-082 për Gazin Natyror; Ligjit Nr. 05/L -052 për Energjinë Termike. Për të pasur bazën konkrete ligjore, duhet të ndryshohet neni 43 i Ligjit për ZRRE ose të shtohet ndonjë nen tjetër që përcakton llojet e autorizimeve, bazuar në fushat e energjisë së ripërtërihem në të cilat lëshohet.

